Kumbona e së Diellës

Giotto - Krishtlindja (Afresk)

Urime Krishtlindja dhe Viti i Ri 2012

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.11/12, Nëntor - Dhjetor 2011

A KA PËRPLASJE MES BIBLËS DHE SHKENCËS?!

Si e përshkruanin Shumerët krijimin e njeriut!

(Pjesë nga libri, Planeti i 12- të)

- Pjesa 5 -

Autori, shprehet se:
"libri në fjalë, nuk ka asnjë kundërshtim midis Biblës dhe Evolucionit.
"Libri i qëndron kohës", thotë autori, dhe "besoj unë, se na tregon të vërtetën për vet zanafillën tonë- dhe që,
NE NUK JEMI VETEM."

ZECHARIA SITCHIN
Planeti i 12 -të
Tiranë, 2009.

Tekstet Mesopotamiane, fatmirësisht na sigurojnë një përcaktimi të qartë lidhur me kohën kur u krijua Njeriu. Tregimi i rraskapitjes e i kryengritjes pasuese të Anunnakive na njofton se "për 40 periudha ata vuajtën punën, ditë e natë" ; vitet e gjata të rraskapitjes së tyre dramatizohen nga vargje që përsëriten.
Për 10 periudha e vuajtjen rraskapitjen; për 20 periudha e vuajtjen rraskapitjen; për 30 periudha e vuajtjen rraskapitjen; për 40 periudha e vuajtjen rraskapitjen.
Teksti i lasht përdor termin " ma" për të shënuar "periudhën", dhe shumica e studiuesve e kanë përkthyer këtë "vit". Por termi kish edhe kuptim e "diçkaje që plotësohet dhe përsërit veten." Për njerëzit në Tokë , një vit barazohet me një rrotullim të plotë të Tokës në orbitë rreth Diellit. Siç e kemi treguar tashmë orbita e planetit të Nefilimeve barazohej me një "shar", ose 3. 600 vite të Tokës.
Dyzet "shar-ë", apo 144.000 vite Tokësore, pas uljes se tyre, Anumnakit ngritën krye. "Jo më"! Nëse Nefilimet u ulen fillimisht në tokë, siç kemi përfunduar, nja 450.000 vjet më parë, atëherë krijimi i Njeriut ndodhi nja 300.000 vjet më parë.
Nefilimet nuk krijuan gjitarë ose primatë apo hominidë. "Adami" i biblës nuk ishte gjinia "Homo", por qenia që është paraardhësi ynë – "Homo sapiensi " i parë. Njeriu modern siç e njohim ne, është ai të cilin e krijuan Nefilimët.
Çelësi për kuptimin e kësaj të vërtete vendimtare gjendet në rrëfenjën e një Enki të përgjumur, ngritur për t' u njoftuar se zotat kishin vendosur të formonin një " adamu", e që ish detyra e tij të gjente mënyrën: Ai u përgjigj:
"Krijesa të cilës ia dhatë emrin- Ajo ekziston" Dhe shtoi: "Bashkojani asaj"- krijesës që tashme ekziston- "Shëmbëlltyrën e zotave." Kështu është përgjigja e enigmës: Nefilimet s'e "krijuan" Njeriun pa asgjë; përkundrazi, morën një krijesë ekzistuese dhe e përpunuan, për t'ia "bashkuar asaj"- " Shëmbëlltyrën e zotave. "... Evolucioni dhe rrëfenjat e Lindjes së afërt për krijimin e Njeriut nuk janë aspak në kundërshti. Përkundrazi, e shpjegojnë dhe e plotëson njëra tjetrën. Sepse pa krijimtarinë e Nefilimeve, Njeriu modern do ishte ende miliona vjet larg në pemë e evolucionit.



Imzot Angelo Massafra
URIMI 4

Papa Benedikti XVI
PËRGATITJA PËR KRISHTLINDJEN 6

At Shtjefën Dodes
KRISHTLINDJA 8

Dom Anton Ukaj
PËRSIATJE E KRISHTLINDJES 10

Loreta Tomaj
NJERIU KJO QËNIE E MISTERSHME 11

Dom Nikë Ukgjini
FISHTA DHE KONFERENCAT NDËRKOMBËTARE 13

Mentor Quku
ZBULOHET GRAMATIKA E MJEDËS 18

Tonin Çobani
FISHTA NË FOKUS 21

Kastriot Marku
AtË LEONARDO DE MARTINO 24

Ndue Dedaj
AtË FABIAN BARKATA 27

EKSPOZITË E OBJEKTEVE TË FISHTËS 31

VITRINA E LIBRIT 32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXVI, nr. 11/12 (434-435) Nëntor - Dhjetor 2011

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
***Imzot* Angelo MASSAFRA**

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Atë Mario Imperatori S.I.
Dom Gjovalin Sukaj
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

URIME PËR KRISHTLINDJEN

GËZIMI I KËSAJ DITE KA ARSYE TË JETË SHPËRTHYES

Nuk e mohoj se disa herë kam pyetur veten: Pse një lajm kaq i rëndësishëm u është dhënë kaq pak personave dhe personave të tillë? Kjo është zgjedhja e Hyjit? Kam reflektuar dhe kam kuptuar se Lajmi i Mirë u jepet pak vetëve, është e vërtetë, por nëpërmjet këtyre i jepet edhe të gjithë botës.

Bij dhe bija shumë të dashura,

edhe këtë vit, festa e Krishtlindjes na bënë të mblidhemi përreth një Fëmijë Hyj. Do të doja që të ripërshkoj bashkë me ju, misterin që kremtojmë duke e shikuar atë me sytë e protagonistëve më të vegjël, **barinjve**. Kështu pikërisht, vëllezër e motra, dëshiroj që mes dritave dhe zbukurimeve të këtij qyteti, mes ushqimeve tipike të zonave tona, të drejtojmë shikimin e zemrës nga ata që të parët janë vënë në ecje për të adhuruar Hyjin Fëmijë.

Në kohën e Jezusit, barinjtë nuk konsideroheshin të rëndësishëm: madje përbuzeshin sepse ishin të varfër, pak të pistë, të paditur dhe jo shumë fetarë. Pasuria e tyre e vetme ishte ndonjë dele e pak djathë, dhe pikërisht atyre u jepet lajmi i lindjes së Shëlbuesit, i atij që do t'i pranonte, do t'i donte në mënyrë të veçantë, sidomos sepse ishin të braktisur, të përjashtuar prej shoqërisë. Ngjarja ndodh natën; dhe duhet vënë në dukje se në historinë e shëlbimit ngjarjet më të rëndësishme, shëlbimprurëse ndodhnin natën (krh. p.sh. Dalja).

Si vallë, lajmërimi i ngjarjes shëlbimprurëse u drejtohet në radhë të parë atyre- Barinje? Në të vërtetë, Hyji ia zbulon lindjen e Mesisë, pikërisht njërës prej klasave shoqërore më të përvuajtura dhe të përbuzura të kohës, për shkak se barinjtë konsideroheshin në popullin e Izraelit, aso kohe, si ata që nuk e njihnin ligjin dhe mbaheshin si të papastër shpirtërisht, pasi të qënurit barinj nuk u lejonte atyre të zbatonin me rigorozitet ligjin që Zoti i dha Moisiut dhe praktikat fetare.

Rabinët (mësuesit e ligjit fetar) thoshin se barinjtë, së bashku me mëkataret publik, vështirë se mund të shëlboheshin për shkak të stilit të tyre të jetës. Pra, ata ishin të përjashtuar nga jeta fetare prej mentalitetit të kohës. Dhe pikërisht atyre u jepet të parëve mesazhi i lindjes së Mesinë.

Nuk e mohoj se disa herë kam pyetur veten: Pse një lajm kaq i rëndësishëm u është dhënë kaq pak



personave dhe personave të tillë? Kjo është zgjedhja e Hyjit? Kam reflektuar dhe kam kuptuar se Lajmi i Mirë u jepet pak vetëve, është e vërtetë, por nëpërmjet këtyre i jepet edhe të gjithë botës.

Gëzimi i kësaj dite ka arsye të jetë shpërthyes: na është dhënë një Shëlbues. Kjo është qendra e lajmit. Shëlbimi i mbarë njerëzimit hyn në botë me lindjen e Jezusit të emërtuar me tre tituj të rëndësishëm: Shëlbues, Krisht, Zotëri. Lajmi i lindjes së Krishtit, vëllezër e motra, nuk është një ide, një shëlbim abstrakt, por Lajmi shpall ardhjen konkrete të Shëlbuesit Jezus: ai që është në gjendje të marrë mbi vete njerëzimin tonë të varfër, të plagosur, të sëmurë, të destinuar për vdekjen që ta kthejë atë në bukurinë dhe në gëzimin e jetës. Luka ungjilltar këmbëngul mbi atë "sot". Një sot që për ne përsëritet sa herë që lajmin e mire e pranojmë prej Hyjit, që na solli shëlbimin.

Lajmërimi, pastaj, besimtarë shumë të dashur, shoqërohet prej një shenjë: Engjëlli lajmëtar që nis drejt shpellës së Betlehemit. Në të vërtetë, nëse e mendojmë mirë, me arsyen, vetë barinjtë nuk do ta kishin kërkuar përmbushjen e tij në drejtimin e treguar prej engjëllit: do të kishin shkuar në tempull apo në pallatet e pushtetit: do të kishin kërkuar një Hyj të fortë, të fuqishëm, ndoshta hyjninë e dëshirave tona dhe të frikës sonë. Në të vërtetë, lajmi ka treguar një drejtim të ndryshëm: Betlehemin! Një fëmijë në një grazhd! Aty paraqitet një Hyj i vogël, që dridhet, ka nevojë, është i pafuqishëm. Ky është zbulimi i bërë barinjve. "Hyjit i pëlqen të flasë me të thjeshtët"! Barinjtë, pasi dëgjojnë lajmin, marrin rrugën dhe e marrin "me të shpejtë", pa lënë që ky çast i shenjtë të kalojë, pra, që të ikë rasti i hirit që mund të mos jepet më. Barinjtë na mësojnë kështu se si ta bëjmë një ecje feje. Pa këtë dëgjesë nuk do të kishin mundur kurrë të siguroheshin për vërtetësinë e objektit të lajmit. Në këtë dëgjesë barinjtë i japin zemër njëri-tjetrit. Prandaj ka një dëgjim, një shkuarje, një shikim... që do t'i ndjekë një lajmërim. Kjo dëgjesë nuk lind prej arsyetimeve të tyre, por vetëm prej një besimi që i bën ta pranojnë fjalën "jo porsi fjalë njerëzish, por pikërisht ashtu si në të vërtetë është – porsi fjalën e Hyjit – që vazhdimisht vepron në ju që besoni" (1 Sel 2,13). Barinjtë e "shohin" realitetin e asaj që Zoti i ka bërë të njohin. Dhe atë që shohin nuk mund ta mbajnë për vete: është tepër e rëndësishme. Ka prekur zemrën e tyre. Atë që engjëllit e kanë bërë në qiell, tani barinjtë fillojnë ta bëjnë në tokë: bëhen engjëj, lajmëtarë, ndërmjetës të Fjalës.

Ja, pra, vëllezër e motra, urimi im për ju: kjo Krishtlindje ju dhuroftë befasi e mahnitje në takimin me Zotin Jezus Fëmijë dhe ju dhuroftë gëzimin e entuziazmin që t'ua lajmëroni atë të tjerëve sikurse barinjtë e Betlehemit.

+ Imzot Angelo Massafra
Arqipeshkëv



Duke u përgatitur për Krishtlindjen

Papa Bendedikti i XVI

Jemi në Kohën e Ardhjes, në periudhën përgatitore për Lindjen e Shpëtimtarit të njerëzimit. Në udhëtimin e shpirtit, secili prej nesh përpiqet të thellohet më tepër në misterin e jetës dhe të mësojë të vërtetat e përjetshme, që hedhin dritë mbi të dhe mbi qëllimin e saj. Periudha përgatitore e Ardhjes, para Krishtlindjes, na jep mësime të çmuara dhe drejtimin e duhur për pritjen e Shpëtimtarit tonë. Le të udhëtojmë së bashku përgjatë kësaj periudhe që të ndriçohemi prej mësimeve jetëdhënëse të Kishës.

Periudha e Krishtlindjes në Kishën Katolike fillon me Ardhjen, e cila zgjat katër javë e, nis me thirrjen "të rrimë zgjuar e të përgatitemi për Ardhjen e Zotit". Koha liturgjike e Ardhjes është kohë e thirrjes nga ana e Jezusit Zot e Shpëtimtar. Ai na fton të shkojmë ta shohim, ta takojmë.

Së pari, ne duhet të shohim Krishtin - njeri. Duhet ta njohim si qenie konkrete njerëzore, hebre, mësues, profet. Ta takojmë si foshnjën e Marisë, si birin e marangozit, si nazaretasin. Më pas, pasi sytë tanë të hapen dhe zemrat të pastrohen, do të shohim "gjëra më të mëdha". Ne do ta njohim jo thjesht si një mësues, por si Mësuesin, jo thjesht si një profet, por si Profetin, jo thjesht si një bir njeriu, por si Birin e njeriut, të parafolur nga profetët. Do ta

shohim jo thjesht si një bir i Hyjit, por si Birin e Hyjit, i Lindur prej Atit para të gjithë shekujve. Ne do ta shohim si Fjalë e Zotit në trup njerëzor, si Ikonë e Hyjit në formë njerëzore. Dhe së fundi, do ta shohim Atë si vetë Hyjin.

Hapi i parë në udhëtimin drejt Krishtlindjes është takimi me njeriun Jezus. Nëse dëshirojmë vertet të shkojmë, me siguri edhe do të shohim. Ashtu si Filipi e Natanaeli, që në Ungjillin e Shën Gjonit, shkojnë për të parë nëse mund të vinte gjë e mirë nga Nazareti, edhe ne, sipas premtimit të Krishtit, do të shohim "gjëra më të mëdha" nga sa presim. Do ta njohim se kush dhe çfarë është Ai në të vërtetë. Së pari duhet të shkojmë. Nëse nuk shkojmë, nëse nuk nisemi udhës, që na çon në Betlehem, nuk do ta shohim kurrë Hyjin e Mishëruar për shpëtimin tonë.

Gjatë ditëve të Ardhjes, para Krishtlindjes, Kisha na ndihmon t'ia përgatisim vendin në zemrat tona Zotit, që vjen në kohë, në histori e në natyrën tonë njerëzore.

Jezu Krishti, Biri, Fjala e Hyjit është formuar fizikisht e shpirtërisht në trupin e Marisë, kështu që Ai mund të formohet edhe në ne. Ky është kuptimi i Krishtlindjes, i cili është dhe kuptimi i vetë jetës: Krishti në ne dhe ne në Krishtin. Hyji me ne dhe ne meHyjin.

Ndërsa fillojmë udhëtimin drejt Krishtlindjes, rruga para nesh është e qartë. Ne mund të ndjekim "rrugën e ngushtë" që na çon te jeta, ose mund të vazhdojmë "rrugën e gjerë" që na çon në shkatërrim. (Mt. 7:13-14)

E kremtimi i kohës së Ardhjes shënon dhe lajmërimin e Lindjes së Krishtit. Kjo kohë liturgjike e shpirtërore na kujton ngjarjen madhështore të festës së Krishtlindjes: "Ja Krishti lind, lavdërojeni; Ja Krishti i qiellit vjen, dilni priteni e në zemra pranojeni".

Nëse nuk nisemi e shkojmë nuk do të shohim kurrë. Por nuk mjafton vetëm të shkojmë te Krishti. Ne duhet ta shohim me të vërtetë. Shumë njerëz e panë Krishtin kur erdhi në tokë e mori natyrën tonë njerëzore, por jo të gjithë e panë Atë si Birin e Hyjit dhe Shpëtimtarin e botës. Ka shumë njerëz, që vijnë në kishë dhe, ende nuk shohin. Krishti na e thotë edhe psenë. Arsyeja, thotë Ai, është se ata duan errësirën më shumë se dritën, sepse veprat e tyre janë të liga. (Gjn 3:19)

Periudha e Ardhjes është kohë kremtimi, ngazëllimi dhe gëzimi. Kisha i fton të gjithë të kremtojnë. Jemi krijuar të galdojmë për dhuratat e Hyjit dhe për vetë Zotin. Ky është thelbi i jetës sonë. Jemi krijuar të jemi "imituesit e Hyjit" dhe "pjesëmarrës të natyrës hyjnore". Zoti është Hyji i të gjallëve, prandaj ne jemi krijuar për të jetuar; Zoti është i mirë, prandaj ne jemi krijuar për të qenë të mirë; Zoti është i urtë, prandaj ne jemi krijuar për të qenë të urtë; Zoti është i mbushur me paqe, gëzim, mirësi, dashuri, fuqi dhe zemërgjerësi, kështu duhet të jemi dhe ne.

Lindja e Jezusit lajmërohet në botë si shpallja e gëzimit të madh. Po kështu engjëjt, që u sollën barinjve lajmin e gëzimit të madh, shpallën, duke i thurur lavde Hyjit, paqe mbi dhé dhe mbi njerëzit vullnetmirë. Krisht Lind - prek dhe mbush qiellin dhe tokën.

Krishti Lind – ndër njerëzit vullnetmirë. Krishti Lind – Zoti erdhi në tokë. Krishti Lind – Hyji i dhuroi njeriut dashurinë, gëzimin dhe jetën më të ëmbël. Krishti Lind – gëzohuni!

Në këtë Krishtlindje, Hyji na bëftë të denjë për të marrë në zemër Jezusin Foshnje, duke i lejuar t'i mbushë ato me dritë e bekime Hyjnore.

Atë Shtjefën Dodes, SJ.
Innsbruck-Austria

Krishtlindja

Festim e një jete të re

Meditim për Krishtlindje

Kur e dëgjojmë porosinë ungjillore para Krishtlindjeve: "Zoti po vjen!" – "Përgatitni udhën", dhe në vetë festën lajmin e gëzueshëm: "Zoti erdhi ndër ne", apo "Zoti është me ne", mund të pyet dikush: E si duket kur Zoti vjen në tokë? Ç`mund të ndodhë, nëse e takojmë Zotin? A thua është kjo një arsye për t`u shqetësuar apo është nxitje për një festim të madh për fillimin e një bote që po vjen, ku mbretëron paqja dhe pajtimi?



Në Natën e Krishtlindjes festojmë fillimin e një jete të re. Drita e Zotit shndrit në botën tonë mëkatare. Është kjo një festë që karakterizohet me ngjyrat më të mira: me ngjyrën e bredhit, pemës së Kërshëndellave, me ngjyrën e kuqe të yjeve nëpër bredha e vende të zbukuruara, me ngjyrën e artë të qirinjve të ndezur ... Në terrin e dimrit jemi më të ndjeshëm për shumëllojshmërinë e ngjyrave që i takojmë, edhe në kishë. Ato me simbolikën e tyre na bëjnë të ndjehemi të bashkuar. Ngjyra liturgjike e Ardhjes (Adventit) është vjollcë, ngjyrë e nisjes, vendosjes, pendimit dhe kthimit. Ngjyra vjollcë për Krishtlindje zëvendësohet me të bardhën. Kjo është ngjyrë e gëzimit dhe festës, pastërtisë dhe madhërisë. Një shkëlqim ngjyrash gëzimi na shoqëron veçanërisht në Natën e shenjtë.

"Populli, që jeton në errësirë, pa një dritë të shkëlqyeshme; mbi ata që jetojnë në vend errësire, lindi një dritë" (Is 9,1) Këto fjalë profetike e kanë prejardhjen nga një kohë e turbulluar e pashpresë, kur në Jerusalem po mbretëronte frika. Në këtë jetë të pashpresë flet profeti Isai: "Populli, që jeton në terr, pa një dritë të madhe." Njerëzit e asaj kohe po përjetonin ndjenjën e pafuqisë për të gjetur një rrugëdalje. Për këtë arsye profeti flet për dritën që ndriçon për befasi në terr. Kur bëhet errësirë të gjitha sendet i sheh vetëm në ngjyrë hiri, ato bëhen të përhimëta, vijat dalluese disi humbin nga pamja e nuk vërehen. Terri është një figurë për situata të këqija të njerëzve në nevojë, sëmundje, pikëllim, luftë, përndjekje dhe vetmi. Në terr dëshiroj ta shoh dritën, qiriun më të vogël, sepse drita jep orientim dhe siguri, bën që të shihet qartë dhe më ndihmon që ta jetoj jetën.

Betlehemi rreze e Jezuesit foshnje

Krishtlindjet i lidhin dy simbole shumë të vjetra njerëzore: dritën dhe fëmijën e posalindur. Isaia, fliste qysh para qindra vitesh para lindjes së Jezusit për një foshnje të pritur. Krejt mbështetjen, krejt besimin e shpresat i mbështet në këtë fëmijë të lindur: "Sepse një djalë na lindi, një bir na është dhuruar. Me krahët e tij mban pushtetin" (Is 9,5a). Dhe profeti i jep kësaj foshnje emra të pazakonshëm: "Këshilltar i mrekullueshëm", "Zotëri i pushtetshëm", "Atë i amshuar", "Princ i paqes" (Is 9,5b). Me këtë është menduar para së gjithash mbreti i atëhershëm. Një mbret i ri qëndron për një shpresë të re. Një mbret, që më në fund sjell paqen dhe i mund padrejtësitë shoqërore. Shpresat e Isaisë megjithatë në kohën e tij nuk u plotësuan. Mirëpo në të gjitha errësirat njerëzit i ruanin fjalët e profetit, dhe i mbartnin prej gjenerate në gjeneratë. Premtimi i tij u plotësua vetëm në Besëlidhjen e Re në Jezu Krishtin. Lindja e tij qëndron për një fillim radikalisht të ri, për një jetë të re.

"Çdo fillim mbartë më vetvete një magjepsje", thurte vargje poeti, Hermann Hesse, gjatë Luftës së Dytë botërore. Magjepsja e Jezu Krishtit e shndrit Natën në botën që po jeton në luftë që nuk po i dihet mbarimi. Urrejtja ndërmjet njerëzve dhe popujve bëjnë pjesë në realitetin e ditëve tona. Lajmi i Krishtlindjeve nuk do të thotë: papritmas ja bota e pajtuar, paqe gjithkund. Lajmi ka domethënie edhe më të madhe: Mu në mes, në errësirën e botës, në terrin e botës sime vjen Zoti. Ai nuk zgjedh tjetër botë, por lind mu në mesin e jetës sonë, në rrethanat e jetës konkrete. Dhe Zoti nuk vjen si Mbret i pushtetshëm me pallate hyjnore për ne, por si fëmijë i vogël që ka nevojë për mbrojtje.

Jezuesi – arti e ikonografia

Edhe pikturat e hershme të Betlehemit i paraqesin rrezet e Jezusit foshnje jo duke ardhur prej së jashtmi, por ato dalin prej së brendshmi dhe shndrisin botën jashtë. Drita rrjedhë prej vetë Jezu Krishtit. Ai shkëlqen me ngjyrë ari. Në artin e krishterë dhe në ikonografi janë paraqitur shpesh herë edhe shenjtërit me rreze ari, me aureolë, me një shkëlqim të artë. Shkëlqimi i artë, aureola, na thotë: Nëpërmjet këtyre njerëzve shkëlqimi i dashurisë së Zotit ka ardhur në botë. Në Jezu Krishtin botës i ka shndrit drita e dashurisë së Zotit. Nëpërmjet lindjes së tij e dimë se Zoti ynë qëndron krejt afër njeriut. Ai nuk mbretëron, siç mendohej deri atëherë, prej së larti, me skeptër të hekurt në dorë, larg (diku). Nga dashuria për ne e dërgon të birin e vet në botë. Ky bir kur të rritet do të thotë që mbretëria e tij nuk konsituon në atë se çka ke, por në atë se çka je – ti je fëmija i Zotit. Ai s`e këqyr shkëlqimin e jashtëm, por zemrën.

Jezu Krishti nëpërmjet dashurisë së tij ka treguar se falja dhe fillimi i ri janë të mundshëm. Lajmi i tij na ndihmon ta njohim, ta shohim, se çka vlen përnjëmend në jetën tonë. Gëzimin dhe entuziazmin e Krishtlindjeve për këtë arsye njerëzit e ndajnë njëri me tjetrin tash e 2000 vjet. Ky gëzim zgjat më gjatë se ndodhitë njerëzore. Gëzimi i iniciativave njerëzore shpejt kalon. Te iniciativat e Zotit ndodhë ndryshe. Gëzimi i Krishtlindjeve zgjatë pandërprerë. Kjo ngjarje nuk është finalja, loja e fundit, por është fillim i diçkaje të re që nuk mund ta marrim me mend: Drita e Zotit e ka marrë një fytyrë - një fytyrë foshnje në shpellë. Drita, që ky fëmijë rrezaton, e ndryshon botën. Sepse Biri i Zotit vjen në botën tonë, për këtë arsye jeta ime do të shkëlqejë dhe nuk do të jetojë në errësirë. Prandaj, unë e ndiej gëzimin, e shoh në dritën e foshnjës së lindur më të mirën ngjyrë dhe vijat dalluese të qarta në jetën time.

Në këtë kuptim teologu Kral Rahner i këndonte kësaj nate:

"Krishtlindje do të thotë: Ai ka ardhur.
Ai e ka ndriçuar natën.
Ai natën e errësirës sonë,
natën e pamundësisë sonë për të kuptuar,
natën e përhimët të frikës dhe pashpresës sonë
i ka bërë ato Kërshëndella, natë të shenjtë.
Zoti, Fjalën e tij të fundit, më të thellën,
më të bukurën
Fjalën e mishëruar në botë, e tha me shpirt.
Dhe kjo Fjalë do të thotë:
Unë ty të dua, ty botë dhe ty njeri.
Po, ndizni qirinjtë, dritat!
Ato kanë më shumë të drejtë se krejt errësira."

Dom Anton Ukaj
Romë

Përsiatje mbi Krishtlindjen

Shpesh herë dëgjojmë : në familje, në katekizëm, në predikime të meshtarëve, apo lexojmë në shkrime të ndryshme, se lindja e Krishtit, i ka sjell botës harmonin, gëzimin, paqen, dashurin, shpresën, jetën më të mirë. Dhe, nëse ndalemi dhe e shqyrtojmë zemrën, brenda saj do të zbulojmë diçka tjetër, si: inatin, xhelozin, mllefin, pakënaqësinë, përçarjen. Po, nëse do kalonim nga shqyrtimi i zemrës te familja, edhe aty takojmë: marrëzi, monotoni, egoizëm, indiferentizëm, hakmarrje, vakësi, vetmi etj. Dhe se fundi, nëse do zbresim nga familja te shoqëria që na rrethon, atëherë do binim në një pesimizëm edhe më të hidhur, sepse këtu do gjenim, individualizëm të theksuar, materializëm, relativizëm, hedonizëm, korrupsion, padrejtësi, varfëri, kriminalitet, etj, Prandaj, më të drejt shtrohet pyetja, çfarë na solli Krishtlindja?

Përgjigjën në pyetjen e parashtruar, besimtari apo jo besimtari do e gjej, duke e soditur Falen e Hyjit. Me ketë rast do i referohemi, Shën Gjonit ungjilltar, i cili me shkrimin e tij brilant, me përmbajtje sa teologjike aq dhe filozofike do shprehej, "Drita e vërtetë që shndrit çdo njeri, erdhi në botë. Ishte në botë e bota u krijua prej Saj, e bota nuk e njohi. Erdhi ndër të vetët, e të tijtë nuk e pranuan. Atyre që e pranuan dha zotësinë të bëhen bijtë e Hyjit: atyre që besojnë në Emrin e tij. Këta s'i bëri bij të Hyjit as gjaku as prirja e mishit as prirja e njeriut por – Hyji" (Gjn 1, 9-13).

"Erdhi ndër të vetët, e të tijtë nuk e pranuan". Ky fragment i Shën Gjonit, ndërlidhet me mospranimi e Jezusit nga ana e njeriut. Çka do te thotë, refuzim i të gjitha vlerave, të cilat janë karakteristik e një harmonie të jetës se njeriut me dhe Zotit.

Prania e mëkatit në botë, la pasoja të renda në zemrën dhe jetën e njerëzve. Por, pa dyshim, mishërimi i Hyji, në personin e Jezu Krishtit, i solli vërtet mbarë njerëzimit dhuratën e paqes, gëzimin, harmonin dhe dashurin të pa fund. Dhe jo vetëm kaq! Tekstet e shumta biblike, të shkruara nga dëshmitarët okular (apostujt), dëshmojnë qartas, se vetë Jezusi është Paqja. Ai është gëzimi, dashuria, rruga e vërteta dhe jeta, për të gjithë ata që e besojnë dhe e pranojnë at, për Hyj në jetën e tyre.

Pra, i krishteri, me plotë të drejtë beson dhe pohon, se Krishtlindja, botës i solli gëzimin, shpresën dhe jetën. Hyji, si një fëmijë e thjeshtë dhe të varfër i Betlehemit, është bërë i dukshëm, duke e mbushur mbarë njerëzimin me dashuri. Shën Irenej rrëfente: "Biri i Hyjit është bërë njeri në mënyrë që njeriu, i bashkuar me Fjalën, të mund të pranojë adoptimin dhe të bëhet bir i Hyjit".

Lajmi kumbues i Krishtlindjes, nuk është vetëm një lajm i thjesht i mirë i së kaluarës, por diç dhe me tepër!? Kremtimi i Krishtlindjes nuk është vetëm një përkujtim i një ngjarje që ka ndodhur para dymijë viteve, e aq më pak, vetëm një paraqitje shenjte, që ne sot e realizojmë përmes shfaqjeve të Krishtlindjes, apo përmes rregullimit të 'Betlehemit' etj,!? Ajo, nuk është një kujtim i një ngjarje, një mallëngjim ndaj së kaluarës, një poetikë e imagjinuar, një lojë ndjenjash apo diç tjetër!?. Kërshndella është lindja e Jezusit; lindja e Njeriut të ri. Në Te, ne takojmë Hyjin. Secili njeri që e pranon bëhet krijesë e re: "Sot, në qytetin e Davidit ju lindi Shëlbuesi - Krishti Zot! Sot Drita shkëlqen mbi ju. Vërtet u duk hiri i Hyjit që u sjell shëlbimin të gjithë njerëzve". Kjo është porosia e Fjalës liturgjike në kremtimin e Krishtlindjes.

Njeriu, përballë kësaj dashurie të madhe të Hyjit për botën, me plotë të drejtë në mënyrë mahnitëse pyet vetveten: Çfarë më duhet të them, përballë kësaj mrekullie të dukshme dhe të prekshme ? Njeriut më këtë rast sikur i mungojnë fjalët. Gjuha dhe goja nuk janë të aftë të shprehin këtë ngjarje të madhe hyjnore! Për këtë arsye, ja vlen t'i bashkëngjitëm korit të engjëjve dhe këngës së tyre: "Lavdi Hyjit në më të lartin qiell e paqe mbi tokë njerëzve, që i ka për zemër!".

Shën Augustini i frymëzuar nga ngjarja e mrekullueshme e Krishtlindjes, brohoriste: "Zgjohu, o njeri, për ty Zoti është bërë njeri!".

Prandaj, të zgjohemi! Jezusi është mishëruar, të gëzohemi! Jezusi ka lindur, ta lavdërojmë! Jezusi ka zbritur nga qielli, t'i shkojmë në takim! Jezusi është mbi tokë, ta pranojmë në zemrën dhe familjet tona! Ky është besimi ynë, kjo është ngjarja që ne e kremtojmë.

Loreta Tomaj
Shkodër

NJERIU
KJO QENIE E MISTERSHME

(Pjesa e tetëmbëdhjetë)

VI. VETËVLERËSIMI

Identiteti është një koncept, kurse vetëvlerësimi është një përvojë. Vetëvlerësimi është një nevojë natyrore dhe qendrore, aq sa disa psikologë vënë mbi të konceptimin e tyre të personalitetit.

Pa vetëvlerësim është e vështirë të jetohet, ndoshta e pamundur: njeriu e ndien veten se është jokompetent, inferior, çdo rrethanë e jetës kthehet në një kërcënim, derisa njeriu largohet nga shoqëria apo përdor mekanizma mbrojtës.

Vetëvlerësimi bën të lindë ajo lloj sigurie dhe besimi në vetvete, që janë themelore për t'u bërë ballë angazhimeve të jetës dhe marrëdhënieve me të tjerët: vetëm nëse është i sigurt për vetveten, njeriu me të vërtetë mund të dhurohet dhe të dojë, të braktiset dhe të humbë pa pasur nevojë të mbrohet.

Sipas mendimit të përgjithshëm të psikologëve, të zgjidhësh problemin e vetëvlerësimit do të thotë t'i japësh vetes *një vlerësim realistik thelbësisht pozitiv dhe të qëndrueshëm*. Pjesë e vetëvlerësimit janë: njohja objektive e vetvetes (kushti bazë), aftësia për të vlerësuar atë që njeriu është (lindja e vetëvlerësimit), tensioni i shëndetshëm drejt të mirës-vlerë (realizimi i procesit të vetëvlerësimit), integrimi i negatives së pranishme në jetën njerëzore (plotësia e vetëvlerësimit).

1. Njohja objektive e vetvetes

Kemi njohje objektive të vetvetes atëherë kur individi është në gjendje të perceptojë në mënyrë realistike përbërësit e ndryshëm të unit të vet, nga uni i shfaqur deri tek uni ideal institucional.

Njohja e vetvetes, që nuk përfshin unin e fshehtë është e pjesshme, subjektive dhe shpesh e shtrëmbëruar meqë uni i fshehur vazhdon të veprojë, por, meqë nuk njihet, nuk verifikohet nga subjekti në modalitetet e veprimit dhe të ndikimit të tij.

2. Aftësia për të vlerësuar atë që jemi (uni aktual)

Është vlerësimi pozitiv i asaj që njeriu është, me të gjitha dhuratat dhe energjitë e lindura, duke u nisur nga dhurata e ekzistencës. Për këtë, vetëvlerësimi është më shumë diçka për t'u zbuluar, sesa diçka që duhet fituar apo mësuar, është më shumë diçka që duhet të gjendet brenda vetes sonë, sesa jashtë nesh. Në fakt, ai është i rrënjosur në një pozitivitet "të strukturës", që, megjithëse është një embrion (një farë) për t'u zhvilluar ai "e shënon" thellësisht qenien tonë, dhe nuk resht të jetë i tillë edhe kur ne e shpërfillimin apo e përgënjeshtrojmë. Zakonisht ne e kërkojmë vlerësimin jashtë vetes, nga të tjerët, nga rolet, nga rezultatet. Atë na e ka dhënë natyra dhe është për çdo qenie njerëzore,

edhe për atë që s'ka rezultate, që s'ka aftësi të veçanta, që s'bën gjëra të jashtëzakonshme, por me një kusht ama: të dijë ta perceptojë veten në mënyrë realistike dhe ta vlerësojë veten për atë që është.

Kjo nënkupton: aftësinë për të dalluar atë që është thelbësore (në kuptimin e lidhur me thelbin

tonë) nga ajo që nuk është apo që është më pak (domethënë duke u identifikuar në nivelin racionalo-shpirtëror), dhe aftësinë, si rrjedhojë, për t'u kënaqur me atë të mirë thelbësore që njeriu gjen në vetvete. Nuk mjafton vetëm perceptimi racional, nevojitet edhe një ndjesi pozitive, një aftësi për të shijuar pasurinë e qenies sonë: dhurata e ekzistencës, energjitë e lindura të njeriut që e bëjnë atë të aftë të shkojë përtej vetvetes dhe ta dojë tjetrin, shprehjet origjinale të çdo njeriu, prirja drejt së vërtetës... Dhe vetëvlerësimi lind këtu, në aftësinë e njeriut që të dijë të shijojë çdo ditë e më shumë një të mirë thelbësore që zotërojmë pa u dëshpëruar për ato të mira rastësore (intelektuale, artistike, morale...), që i zotërojmë vetëm në mënyrë relative. Nëse është e vërtetë që vetëvlerësimi vjen nga brenda, kjo është rruga e vetme që na liron nga të qenët në mënyrë kronike i varur nga konsideratat dhe vlerësimet e të tjerëve (të paqëndrueshme) dhe nga nevoja për ideale irrealistike (gjithmonë të pakënaqura).

3. Tension i shëndoshë drejt të mirës (uni ideal)

Uni aktual nuk mjafton për të krijuar vetëvlerësimin. Njeriu ka nevojë të priret drejt plotësimit dhe realizimit të vetvetes. Vetëvlerësimi është një koncept dinamik dhe si i tillë përbëhet nga disaelemente:

-- Identifikimi i të mirës reale dhe i të mirës totale dhe aftësia për ta çuar atë deri në pjekje

Për të mirë reale nuk kuptojmë të mirën në vetvete (të mirën absolute), por "të mirën për mua" apo atë të mirë që i përgjigjet situatës ekzistenciale të çdo personi konkret (ajo që unë duhet të bëj në gjendjen time).

Për të mirë totale kuptojmë atë të mirë që kënaq parimin e totalitetit. P.sh.: babai që mbytet në punë për të fituar para, por që s'ka kohë të flasë me fëmijët e vet, ndjek një të mirë të pjesshme.

Kur njeriu zgjedh një ideal që s'është në harmoni me të vërtetën e unit të tij dhe/apo me totalitetin e qenies së tij, nuk do të dijë ta vlerësojë veten. P.sh.: babai që punon shumë dhe merret me shumë njerëz, por që harron fëmijët e vet, mund të kënaqë disa nevoja të veta (afirmim, miqësi, arritje...) dhe mund të kënaqë për momentin edhe atë të vetëvlerësimit, por meqë lë pas dore diçka më thelbësore-totale, vetëvlerësimi i tij do të mbetet i prekshëm apo i paqëndrueshëm dhe i varur nga miratimi i të tjerëve.

-- Largësia optimale mes unit aktual dhe unit ideal

-- Ekzistojnë dy rreziqe: largësia e tepruar dhe mungesa e largësisë mes unit aktual dhe unit ideal:

- Rreziku i parë është për atë që ka ideale shumë të larta, gati të pamundura apo për atë që nuk ka besim në unin e vet aktual dhe nuk e quan veten të aftë të priret drejt një ideali më të lartë (apo një uni ideal tepër të lartë apo një uni aktual tepër të ulët). Personi s'do të ketë besim në vetvete dhe do të largohet nga shoqëria.

- Rreziku i dytë është për atë që mendon se e ka arritur unin ideal, sepse e ngatërron njohjen dhe zgjedhjen e një vlere me aftësinë për ta jetuar atë në mënyrë koherente, apo për atë që ka një ideal jete kaq horizontal dhe pak provokues sa mund ta identifikojë mjaft mirë atë që është me atë dëshiron të jetë (ose një unë aktual mendjemadh ose një ideal që praktikisht nuk ekziston). Personi do të ketë një mendjemadhësi të shtirë dhe do të përzihet në punët e të tjerëve.

-- Largësia optimale mes unit aktual dhe unit ideal është ajo largësi që:

- nga njëra anë është e përshkueshme dhe e mundshme dhe nga ana tjetër shpëton natyrën e të mirës-vlerë, që është e paarritshme;

- nga njëra anë ushtron një tërheqje të fortë, që e shtyn subjektin të ecë dhe të shijojë-të njohë gjithnjë e më shumë vlerën, nga ana tjetër zbulon shkallë-shkallë kërkesat e veta dhe ushtron një shtytje gjithnjë e më të madhe mbi individin.

Largësia optimale përkufizohet në një marrëdhënie ekuilibri dinamik mes këtyre dy çifteve të kundërta: e arritshme-e paarritshme, tërheqëse-kërkuese, që janë edhe karakteristikat e konceptit të vlerës. Nga ana vepruese do të kemi një individ në të cilin uni aktual pranon thirrjen e unit ideal dhe përpiqet të priret drejt tij, por ndërsa i afrohet të mirës-vlerë kjo sikur largohet gjithnjë e më shumë; me fjalë të tjera: sa më shumë që subjekti angazhohet në nivelin e unit aktual dhe zbulon kuptimin dhe bukurinë e unit ideal, aq më shumë i kupton edhe kërkesat konkrete për jetën e vet dhe mënyra gjithnjë të reja për ta realizuar atë. Në masën që zhvillohet uni aktual, përparon edhe uni ideal: është "krejt" individi që rritet (parimi i totalitetit) dhe bashkë me të rritet edhe vetëvlerësimi.

Dr. Dom Nikë Ukgjini
Shkodër.

Fishta dhe Konferencat Ndërkombëtare

Ligjërata e mbajtur në "Java e Albanologjisë" , organizuar nga Institutit Albanologjik, Prishtinë, 14 – 18 nëntor 2011.
Dega e Historisë: Shqiptare në Kongreset dhe Konferencat Ndërkombëtare.

Hyrje

Populli shqiptar në përballje historike, të frymëzuar nga heronjtë e luftërave dhe të kulturës kombëtare, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi, kishin arritur, hap pas hapi, të ndërgjegjësoheshin duke rikrijuar programe të reja, për kundërshtime, ndaj perandorisë se egër osmane.

Ky fakt dëshmohet dhe më rastin e Kongresit të Berlinit (1878), si dhe të Konferencës se Londrës (1913), kur të Fuqive të Mëdha evropiane dhe Perandoria Osmane, duke i identifikuar shqiptarët të islamizuar në masën 70 % me turqit, i benë plaçkë tregu, tokat shqiptare, ndërmjet, Greqisë, Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Shqiptaret të mbledhur tok rreth flamurit kuq e zi, u shprehën ashpër kundër këtyre vendimeve të pa drejta, duke organizuar peticione, protesta, lëvizje dhe konferenca kombëtare, si : Lidhja e Prizrenit, 1678, Kuvendi i Pejës 1899, Kuvendi i Ferizajt 1910, Kryengritjet e Malësisë se Madhe 1911, ato të 1912 –es etj.. Vendime e lartpërmendura, nuk mbrapsen shqiptaret, në kërkesa e tyre legjitime, por, përkundrazi ishte një nxitje, edhe më e theksuar e atdhetareve dhe intelektualeve, për të ngritur zërin e arsyes, për zgjidhjen e çështjen sonë kombëtare. Në mesin e atyre të shumtëve, qe kontribuuan në këtë drejtim, me ketë rast, do veçonim, poetin tonë kombëtar, At Gjergj Fishta.

Letërsia diplomatike e Fishtës

Situata problematike e këtyre viteve në Ballkan, e në veçanti në trojet shqiptare, nuk kishte e të mos e shqetësonte, shpirtin qe në moshë të re të poetit Fishta.

Fishta i lindur, më 22. tetor 1871, në Fishte të Zadrimës, gjatë kohës studentore në Bosnje, vitet 1886-1893, nuk kishte si të mos e shprehte, para studenteve boshnjak dhe eproreve të tij, krenarin dhe njëherazi dhimbjen, për atë, çfarë po ndodhte më popullin e tij, i cili akoma dergjej nën pushtimin e Perandorisë e osmane.

Gjatë studimeve teologjike në Livno, duke qenë vazhdimisht i përbuzur, nga një grup studentesh si dhe eprori i tij, Augustin Çengiq, si zgjim i rilindjes sllave, në kushtet e përjetshme të Urdhrit françeskan, në vitin 1890, në shenjë krenarie dhe heroizmi, për popullin qe i takonte, e mori emrin, Enea Silvio Giorgius Fishta. Dy emrat e parë, ishin të papa Pio II, i cili në vitin 1464 qe nis nga Roma për në Ankona, për ta kurorëzua Skënderbeun, si mbret të ushtrisë aleate, për çlirimin e atdheut nga Perandoria Osmane dhe emri Giorgius, personifikimi i heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti. Fishta, që nga ky moment, nisi epopenë, mendore dhe shkrimore, për ndërgjegjësimin e shqiptareve, për idealin e lart, siç është mbrojtja e atdheut dhe gjuhës shqipe, më çdo kusht, madje deri në flijimin e jetës.

Rikthimi i tij në Atdhe në vitin 1893, nga një vend i çliruar nga Perandoria osmane, dhe ballafaqimi i drejtpërsëdrejti më pushtuesit, osmane dhe më vonë, serbet e malazezet, qenë faktor përcaktues për Fishtën, që në programin e

tij jetësore, krahas detyrave shpirtërore, ta këtë dhe çështjen kombëtare.

Ngjarjet politike neper të cilat marrte shtat Shqipëria jetime, e shtynin Fishtën të rri përherë i zgjuar në pendë në dorë e cila herezi shndërrohej në shigjetë të ngrehur, sipas modelit të ngjarjes biblike të Judës së Makabeve, për " pro aris et focis" për Altar dhe vatër, e cila në gjuhen e Fishtës përkthehej "për fe e atdhe"moto, e cila gjithë jetën e ka shoqëruar poetin tonë kombëtar.

Me shkrimet e tija të botuar në të përkohshmen, Albania (1900-1905), si, "Shcypja e burrit"; "Ma i madhi kob i shcyptaris", "Mali i Zi", etj., "Hylli i Dritës" nga viti i themelimit të saj 1913 e në vazhdim, "Posta e Shqypnis" (19176-1918) "Grueja Shqyptare" (1920), "Leka" , (1929-1944) të paraqitura në formë proze, poezie, lirike, satire dhe dramaturgjike, Fishta, arrinte t`i shtrinte idetë të veta gjithmonë dhe gjithkund, në funksion të mbrojtjes dhe përparimin e atdheut.

Duke bërë, letërsi, publicistit, apologji, kritik, dhe mbi të gjitha polemik, ka ndezur shkëndit e zjarrit, në zemrat e shumë shqiptareve, për ruajtjen e identitetin dhe dinjitetin njerëzor në tokën arbërore, të mbështetur në parimet biblike "Ku është shpirti i Zotit, aty është liria".

Me pendën e tij të art dhe të zjarret, të mbështetur, në drejtësi e liri, kulturë dhe përparimi, arrinte t`i ndërgjegjësonte shqiptarë nga indiferentizmi i kohës, dhe njëherazi të vejë, në lëvizje diplomacinë ndërkombëtare, për zgjidhjen sa më objektive të çështjes së shqiptareve në Ballkan.

Prodhimi më i arritur letrar, më anë të të cilit shpreh, shqetësimin e thellë, ndaj diplomacisë evropiane, për diskriminimin e bërë ndaj shqiptareve, është përmbledhur në veprën jetësore *"Lahuta e Malsisë"* .

Më këtë vepër, me vargjet kushtuar: Kuvendit të Berlinit, Lidhjes së Prizrenit, Luftës Ballkanike dhe Konferencës ë Londrës, diplomati Fishta, ngreh madje, drejtpërsëdrejti, akuza të rënda, ndaj konferencave evropiane, për mos respektimin e vullnetit të popullit shqiptar, për ruajtjen e tërësisë territoriale të trojeve stërgjyshore, të shprehur me protesta, peticione, kryengritjeve e forma të tjera.

Fishta diplomat i pa shpallur

Fishta, krahas punës së tij shkrimore, me sfond politik dhe diplomatik, shqetësimet më popullin e ndante, duke marr pjesë në mënyre aktive, në protestat dhe kryengritjet e tyre.

Me rastin e shpërnguljes së popullatës së paarmatosur, nga Malësia në Podgoricë, Mali i Zi, kur Turgut pasha, në vitin 1910-1911, dogji dhe poqi, Malësinë e Madhe, figura qendrore, e nxitjeve popullore dhe bisedimeve me ndërkombëtaret në Podgoricë, krahas, Imzot Jak Serreqit, si përfaqësues zyrtar i kishës së Shkodrës, pa dyshim ishte, Atë Gjergj Fishta.

Qëndrimi i tij dhe i Luigj Gurakuqit, i prerë ndaj perandorisë osmanen, sollën si rezultat miratimin e 12 kërkesave nga ana e malësoreve të njohur si Librin e Kuq, më 10-25 qershor 1911, në Kuvendin e Gërçës, ku malësoret, me këmbëngulje kërkonin krijimin i një province autonome shqiptare, përkatësisht bashkimin e katër vilajeteve në një të vetëm.

Në kohen kur Shkodra, më 9. tetor 1912 deri më 22 prill 1913, mbahej e pushtuar nga malazezet, në këto dite të zymta, kur pushka dhe çizmja e ushtarit, fliste më tepër se diplomacia, Fishta edhe pse i mbyllur në Kuvendin, te Arra e Madhe, pati kurajë, t`i fliste popullit, për rrezikun qe i kërcohej, nga serbet dhe malazezet, nëpërmjet provincialit të tij në Rubik, Atë Pal Dodaj.

Pas largimit të ushtrisë, malazeze nga qyteti dhe ardhjes së ushtrisë

ndërkombëtare, më 14 maj 1913, në kambanoren e kishës së Gjuhadolit, me kërkesën e Fishtës, u valëvit flamuri kuq e zi. Me këtë rast nga zemra e poetit të ngujuar, burojë teksti i himnit kombëtar, *"Porsi fleta e Engjillit t` Zotit, Po rreh Flamuri i Shqypnisë"*.

Ky veprim heroik i Fishtës, pas shumë debateve diplomatike, më kërkesën e kolonelit britanik, Gordon Philips në Shkodër, solli largimin e tij nga Shkodra për në Asizi, të Italisë, për t 'u kthyer, përsëri në vendlindje, në janar të vitit 1916, kur, trupat austro-hungareze, më ketë rast, morën Shkodër.

Me ardhjen e trupave austro-hungareze, sikur filloj një frymëmarrje e re diplomatike dhe kulturore për Fishtën. Me këtë rast, me ndihmën e miku të tij, diplomatit austriak, në Shkodër, August R. von Krajl, filloj botimi i gazetës *"Posta e Shqypenisë"*, një fletore hartimi, kulturore, politike dhe diplomatike, botuar, më 5 dhjetor 1916, deri 23. 11. 1918, në shqip dhe gjermanisht.

Kjo gazetë e themeluar nga Fishta, me përmbajtjen që kishte, nuk i shkonte për shtati, ministrit të Bullgarisë, D. Rizov, së fundi as konsullit të Francës në Shkodër, Bardy de Fourton, si përkrahës i politikës serbe e malazeze, i cili në nëntor të vitit 1918, urdhëroj mbylljen e saj.

Më këtë rast, më 28 nëntor 1918, Ditën e Flamurit, në Shkodër u organizuan protesta të ashpra popullor të udhëhequr nga vetë Fishta.

Me mbylljen e gazetës *"Posta e Shqypnisë"* dhe revistës *"Hylli i Dritës"* shuhej zëri i të drejtave të shqiptareve për pavarësi të plotë dhe bashkimit të trojeve stërgjyshore.

Fishta dhe Konferencat Ndërkombëtare

Pas Kongresit të Shqiptare të mbajtur më 25, dhjetor, 1918, në Durrës, vëmendja e të gjithë shqiptareve, brenda dhe jashtë atdheut, ishte përqendruar në Konferencën e Paqes, në Parisë, e cila punimet i zhvilloj më 18 janar 1919, deri në maj 1920. Gjatë kësaj kohe, Shqipëria gjendej e pushtuar nga forcat ushtarake të disa fuqive fituese, të cilat synonin të dhunonin pavarësinë dhe ta cenonin tërësinë e saj tokësore. Ndërkohë, që përfaqësuesit shqiptarë do t`i kërkonin Konferencës rishikimin e padrejtësive të së kaluarës, më shpresë se mund të respektohej parimi i vetëvendosjes.

Pallati në Versajë

Ndërkohë që delegacioni shqiptar, në krye më Turhan Pashën, delegatët, Luigj Gurakuqin, Mustafa Krujen,, Mehmet Konica, dr. Mihajl Turtulli, etj., ishin nisur drejt Parisit, Imzot Luigj Bumçi, me sekretarin e tij, Gjergj Fishtën, në udhëtim për në Francë, kishin ndaluar, për pakë kohë në Romë.

Bumçi dhe Fishta, atje më parë takuan gjeneralin e Urdhrit të Fretërve, Atë Serafino Cimino, për tu takuar më pas, më 6 mars 1919, në një audiencë me Papa. Benedikti e XV, të cilin e kishin njoftuara gjerësisht, për situatën politike në Ballkan e në veçanti të popullit shqiptar, i cili ishte në rrezik të copëtimit të mëtejshëm.

Delegacionet shqiptare të cilat në shkurt të vitit 1919, kishin arritur në Paris, paraqiten pran Konferencë së Paqes, dy memorandume, me opsione të ndryshme, për ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë si dhe për mundësin e zgjidhjes së problemeve të shqiptareve të lënë jashtë kufijve etnik.

Në të arritur të delegacioneve të tjera nga diaspora shqiptare, opsionet për zgjidhjen e çështjes shqiptare sikur u shtuan. Duke parë se situata shkonte në dëm të shqiptareve, më 28 qershor, 1919, grupi i Turhan Pashës, bëri ndryshime në përbërjen e delegacionit. Si kryetar në vend të Turhan Pashës u caktua, ipeshkvi i Lezhës, imzot Luigj Bumçi. Mënjanimi i Turhan Pashës, që kishte qenë dikur ambasador i Perandorisë Osmane në Perterburg, lidhej më synimin, për të ndryshuar imazhin që propaganda e huaj i vishte Shqipërisë si *"Turqia e vogël"*.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes më 29 korrik 1919, në mes Tittonit të Italisë dhe Venizelos të Greqisë, për ndarjen e Shqipërisë, sipas Konferencës së fshehët të Londrës të vitit, 1915, delegacionet shqiptare qenë të vendosur të bashkëpunonin më delegacionin e kryesuar, nga Luigj Bumçin i cili zgjodhi, sekretar të delegacionit Gjergj Fishtën.

Në letrën e At Fishtës dt. 13 shkurt 1920, shkruar nga Parisi, provincialit At Vinçenc Prennushit, ndër të tjera thuhej : *"Mos tjeter, preh fletoreve do të keni marr vesht, se çë rrezik i zi i kercenohet Atdheut t`onë. Me 20 të Kallndorit Konferenca u ka parashtrue Jugosllavve nji projekt, mbas të cilit Greqija merr Shqipnien jugore me Korçë e Argjirokaster; Italia Vlonen me hinterland e mandat mbi shqypniën e mesme; Jugosllavija pershtrihet deri në Dri ose, ndoshta der n`Mat"*.

Duke qenë se situata ishte e ndërlikuar së tepërmi, në lidhje me shqiptarët, dhe duke mos gjetur mbështetje nga Konferenca, delegacioni shqiptar, sipas letrës të Fishtës, dërgon në Romë, Imzot Bumçi së bashku Mehdi Frashrin, më 28 dhjetor, 1919, ditë e dytë të Krishtlindjeve, te Papa Benedikti i XV. Papa, duke qenë nga takimi i mëparshëm i mirinformuar, rreth problemit shqiptar, dëgjoi më kujdes të madh shqetësimet e delegacioni tonë. Në fund të bisedës, duke qenë i bindur se, rreth çështjes në fjalë, do gjejë mbështetje në partin katolike në Parlamentin italian, në diplomacinë, angleze dhe amerikane, me të cilat Vatikanit kishte marrëdhënie të mira, Papa, pat deklaruar se do bënte, çmos, për ta shpëtuar Shqipërinë nga mos copëtimi i mëtejshëm i saj.

Sipas gazetës *"Le Temps"* thekson Fishta, grupi parlamentarë katolik i Italisë, kishin kërkuar nga kryetari i qeverisë, Nitti, që Italia dhe zyrtarisht, të mos kërkoj copëtimin e mëtejshëm të Shqipërisë.

Për ta ndërkombëtarizuar më tepër çështjen e shqiptareve, Fishta dhe Bumçi më 5 shkurt , 1920, zhvilluan takimin e radhës me kardinalin e famshmen të Brukselit, Disidre Mercier, primat i Belgjikës i cili mori përsipër, t`i shkruar në favor tonin, kardinalit te Londrës dhe të Burnit, ekselencës se tij Balfuorit, pastaj, mareshalit Fosh, Dechanelit, Milerandit etj.

Mundi dhe ndërsa e Fishtës dhe të gjithë tjerëve, qe kurorëzua me pranimin e shtetit tonë, me 30 gusht 1919, nga Brukseli, dhe më pas, më 17 dhjetor 1920, në Lidhjen e Kombeve, me këtë rast Shqipëria, së fundi siguroj tersin e saj, në kufijtë e Konferencës së Londrës të vitit 1913.

Megjithëse Shqipëria ishte anëtare e Lidhjes së Kombeve, akoma nuk qe e pranuar nga Amerika, e cila në Konferencën e Parisit, e përfaqësuar nga presidenti, Wilson, luajti rol jashtëzakonisht të madhe në favor të çështjes shqiptare.

Fishta në letrën e tij, dt. 8. V. 1922, dërguar provincialit, At Pal Dodaj, nga Uashingtoni, thekson se, pas dymbëdhjetë ditëve udhëtimi me vapor nga Anglia, më në fund kishte arritur në Amerikë. Pa humbur shumë kohë, kishte filluar për të bërë lobin rreth çështjes se Shqipërisë. Pas takimi qe pati me françeskanin me ndikim të madh në qarqet diplomatike të Uashingtonit, At Godfried Shilling, Fishta takoi dhe Senatorin katolik, Henri Cabot Lodge, i Partisë Republikane, njeri me autoritet e të madh, dhe i një mendimi më Presidentin Wilson, për të drejtat e barabarta të popujve. Në letrën e lart cituar, Fishta do shprehej *" asht mirë qi Qeveria e Tiranes, t`i dejtojë një shkresë nënsekretarit të Ministrisë së Jashtme të Amerikës, tue kerkue zyrtarisht këtë njohje...* Në fund të letrës, shkruan



Fishta*: "nderkaq vizita e eme në Washington ka pasë si përfundim njohjen e Shqypnis prej anës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës"*.

Fishta, takimet në Uashington, nuk i kishte bërë, në rolin e një deputeti të Shqipërisë, edhe pse ishte mandatar nga populli në dy legjislacione, por si intelektual që kishte marrë famë kombëtare dhe ndërkombëtare. Si i tillë kërkoj njohjen e një vendi tepër të vogël, nga Amerika tepër e madhe.

Konferencat Ballkanike

Qeveria shqiptare, për të mbrojtur interesat e vendit, mori pjesë në disa konferenca ballkanike në vitet 1930-1933, nen kujdesin e Francës, ku merrnin pjesë dhe përfaqësues të Lidhjeve të Kombeve. Në këto takime ndërkombëtare, flitej për krijimin e zonës se paqes në Ballkan si dhe mbrojtjen e të drejtën e pakicave në këto vende.

Në fund të vitit 1930, konferenca qe mbajtur në Athinë, Shqipëria qe përfaqësuar nga At Fishta dhe Mehmet Konica. Fishta në letrën e tij dt. 11 tetor 1930, nga Athina, drejtuar provincialit, At, Vinçenc Prennushit, ndër të tjera, thotë se, Konferenca, nuk kishte sjellë diçka të re, edhe pse Mehmet Konica me referatin e tij, në krahasim më të tjerët, kishte qenë shumë në lartësinë e duhur. Fishta, në ketë Konferencë, qe përqendruar në zhvillimet kulturore në Shqipëri.

Konferenca e dytë qe mbajtur në Stamboll, në vitin 1931, ku të dërguarit të Shqipërisë, rishtas, qenë, Fishta dhe Konica. Kjo Konferencë, sipas Fishtës, qe e organizuar shumë më mirë se ajo e Athinës. Konferenca qe hapur nga Presidenti i Turqisë, Hasan Begu, fjalën e kishte mbajtur dhe Kryeministri i Turqisë, Ismet Pasha. Fishta, në letrën e tij nga Stambolli të dt. 20 X. 1931, drejtuar provincialit, Pal Dodaj, duke bërë një përmbledhje të Konferencës, ndër të tjera shprehet: *"Sod, 21, kemi pas luft më Jugoslav në Komisionin Politik. Mehemt Konica asht sha keqas me Kryetarin e dergatës Jugoslave me nji fare Topalovic. Jovic, Kryetari e Dergates Jugoslave i paska thanë Konitzes se asht i shtim prej dikuj tjeter më prish Konferencen. Konica i paska permendë punet, qi Jugoslavet, kan ba dhe bajnë mbi shqiptaret e Kosovë dhe e paska quejtë barbar"*. Fishta, në vazhdim të letrës, thekson se, për shkak të kësaj ngatërrese, në mes këtyre dy delegacioneve, Konferenca qe rrezikuar të mbyllej para kohe, por, nga ana e jugosllave ishin tërhequr fyerjet e bëra, ndaj delegacionit shqiptar.

Derisa, greket, rumunet dhe Turqia, kishin insistuar, që të nënshkruhej, në ketë Konferencë pakti për pakicat, nga ana tjetër, bullgaret, kërkuan, që kjo çështje të shtyhet për një konference tjetër, e cila do mbahej në vitin e ardhëm.

Pasi çështja e pakicave nuk mori zgjidhjen e duhur, në vitin 1932, u organizuar Konferenca e tretë Ndërballkanike, në Sofje të Bulgarisë, ku morën pjesë të njëjtët aktor dhe pati të njëjtën tematikë. At Fishta, pos rolit të delegatit, tani kishte dhe rolin e provincialit, që përfaqësonte eterit françeskan të Shqipërisë. Kjo konferencë, pësoj fatin e atyre të mëparshme, duke mos sjellë gjë konkrete për temën në fjalë.

Pas këtyre Konferencave maratonë Ndërballkanike, gjëja më e mirë, që ëmbëlsoj shpirtin e trazuar të poetit, ishte pranimi i tij, si anëtar i Bashkimit Ndërkombëtar i Poeteve, organizatë kjo e themeluar në New York. Ky bashkim ndërkombëtar i poeteve, ku merrni pjesë rreth 60 kombe të ndryshme, ishte mënyra më e gjetur, për krijimin e urave të reja të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit, në mes diplomacive të shumta, botërore.

Përfundimi

Sinteza e gjithë veprimtarisë se tij ishte, se nuk ka dashuri të vërtet të atdheut aty ku nuk njihet a ku përjashtohet apo luftohet emri i Zotit. Se patriotizmi nuk është as vetëm një instinkt , as vetëm një modë apo zanat, por përkundrazi, është njohja e atdheut dhe dashuria ndaj tij, deri në vetëflijimin të jetës tokësore. Trupi i poetit të "Lahutës së Malësisë", në vitin 1940, duke zbritur në terrin e varrit, sikur lëshonte një klithëm, për ndërgjegjësimin e çdo shqiptari: "Jo, po: ka Shqypni për, n`iat Zotin"!

Botuar në gazetën:

SHQIP, 23, nëntor 2011.

Mentor Quku
Shkodër

Zbulohet nje Gramatikë shqipe në dorëshkrim!

(Pjesa e fundit)

(vepër autografe e Ndre Mjedës, e pabotuar dhe e panjohur)

Në kontinentin Amerikan zbulohet një dorëshkrim autograf i panjohur i Dom Ndre Mjedës, Gramatika e gjuhës shqipe

Hipotezat dhe kërkimet tona për ekzistencën e gramatikës shqipe të Mjedës

Interesat e Mjedës për studimet shkencore kushtuar gjuhës shqipe zënë fill që në moshë të re. Mjeda e vlerësonte gjuhën shqipe si pasurinë më të madhe të shqiptarëve, prandaj edhe ia kushtoi tërë jetën studimeve gjuhësore. Ishte i ri, 26 vjeç kur zotëronte koleksionin më të plotë të gjithë gramatikave shqipe, përjashto atë të De Radës dhe atë të Leake-ut. Të zotëroje një koleksion të tillë duke filluar nga gramatika shqipe e parë, ajo e Da Lecces (1716), më e para gramatikë në gjithë gadishullin Ballkanik, do të thoshte se kishim të bënim jo me një koleksionist të thjeshtë por me një studiues të pasionuar e mjaft të përgatitur. Për këtë moment vlen deklarata e 1 shkurtit 1900 e albanologut të njohur Teodor Ippen: "*Ky prift ka qenë shumë vjet anëtar i urdhnit jezuitëve dhe doli prej tij mbasi aspiratat e tij kombëtare ndeshën në qëndrimin tradicional të shoqërisë. Anëtarësisë së tij si jezuit i detyrohet ai edukim shkencor që e bën atë të aftë plotësisht për punimet e tij.*" Sipasa të dhënave të sigurta të Ippenit, Dom Ndre Mjeda në vitin 1900 po hartonte një gramatikë shqipe. Vite më parë, Mjeda i ishte lutur Gustav Meyerit që të hartonte një gramatikë të hapur të shqipes, e cila do të duhej për një shkollë shqipe të vërtetë që Mjeda kërkonte të hapte në Shqipëri. Mirëpo ai u sëmur dhe vdiq shpejt. Në të njëjtën kohë Mjeda është kthyer në Shqipëri dhe po bën plane për hapjen e shkollave shqipe, ai ka filluar të hartojë vetë një gramatikë shqipe. Për fillimet e kësaj ndërmarrje të madhe ne kemi botuar studime të shumta, të cilat i kemi shoqëruar me kërkime për gjetjen e kësaj vepre të panjohur të Mjedës. Megjithëse asnjëherë nuk humbëm shpresat për gjetjen e saj, para katër vitesh u detyruam të shprehnim pikëpyetjet, dilemat dhe shqetësimet tona lidhur me këtë vepër

fondumentale të albanologjisë shqiptare: "*A e përfundoi Gramatikën e gjuhës shqipe autori i saj, Ndre Mjeda? A mundet të gjendet sot kjo gramatikë? Cili është fati i saj? Të gjitha këto janë enigma. Vetëm studimet e mëtejshme do të bëjnë të mundur që t'u jepet përgjigje. Mund të jetë botuar pa emrin e Mjedës nga shtypshkronjë e jezuitëve. Por ndoshta pati fatin e shumë veprave të tjera që Mjeda i filloi dhe për shkaqe nuk arriti ta përfundonte. Sot duhet të ruhet diku si vepër e papërfunduar. Por edhe mund të jetë djegur në masakrën që iu bë dorëshkrimeve dhe librave të Mjedës me 1-2 nëntor 1912 duke pësuar kështu fatin e Scodrës."* Është interesant për të kuptuar seriozitetin e Mjedës me të cilin ai iu fut punës për hartimin e Gramatikës shqipe. Ai në vitin 1900 ka futur në dorë Gramatikën e Krahasuar të Brugmannit, pjesën e parë dhe kërkon nga Ippeni që t'i sjellin edhe pjesën e dytë të kësaj vepre. Ka një dokumentacion të plotë që flet për porosinë e kësaj vepre nga Mjeda, për gjetjen, blerjen e saj dhe dergimin në Shkodër, dorëzimin bërë Mjedës dhe proces-verbalin autograf të Mjedës, me të cilin vërteton se e ka marrë librin në dorëzim të firmosur

po prej tij. Deri vonë kemi njohur tri vepra gjuhësore madhore të Mjedës: "Parashtrim i alfabetit, adaptue në Konferencën e ipeshkvijve"(1902); "*Promemorje e gjuhës shqipe*"(bashkëautorësi me R. Nahtigall, 1917); "*Vrejtje mbi artikuj dhe premna prones të gjuhës shqipe"*(1934). Me kalimin e kohës erdhën edhe dy informacione për hartimin nga Mjeda të një gramatike shqipe. Në vitin 1931, Cordignano botoi në Milano, librecin "Gjuha shqipe" (Lingua Albanese). Në këtë vepër vetë Cordignano ka pranuar publikisht se një e treta e veprës, gramatika shqipe, është vepër apo sugjerim i Mjedës. Para disa kohe kemi gjetur një variant në italisht të një gramatike shqipe të Ndre Mjedës në librat e Justin Rrotës. Tani vjen lajmi i gëzueshëm për gramatikën shqipe në dorëshkrim autografe e Mjedës. Në një të ardhme mendojmë të bëjmë analizën e këtyre të dhënave, e kësaj veprimtarie të Mjedës dhe e këtyre dorëshkrimeve autografe të tij.

Për angazhimin e Mjedës për studimet gjuhësore shqipe

Dëshiroj t'i përmbyll këto shënime me vlerësime të autorëve të ndryshëm për studimet gjuhësore të Ndre Mjedës.

Begad Baliu, albanolog, Prishtinë: "*Ai e njeh mirë fonetikën dhe morfologjinë historike, prandaj objektet e tij shkencore i përvijon sipas ligjësive të tyre, njeh mirë metodën historike-krahasimtare prandaj sjell dëshmi të mjaftueshme historike të dokumenteve të kohës dhe shembuijt e marrë në shqyrtim i bën objekt krahasimi mbrenda zhvillimeve të brendshme gjuhësore të shqipes dhe në krahasim me gjuhët fqinje të kohës: kryesisht sllavishtes, latinishtes dhe greqishtes. Ai i njeh mirë kërkesat e gjeografisë gjuhësore prandaj është shumë i kujdeshëm që të rregjistrojë, për aq sa është e mundur, përmasën e paraqitjes së objektit të tij gjuhësor në të gjithë arealin krahinor dhe historik brendashqiptar dhe jashtë tij."*

Ernest Bushati, (1912) inxhinjer kimist, Tiranë, ish student i Mjedës: "*Kam qenë nxanës i Mjedës në vitet 1931-1933, në Shkodër. Na jepte gjuhën dhe letërsinë shqipe. Na ka dhanë edhe histori. Në gjuhë ishte*



jashtëzakonisht i thellë dhe gjuhën shqipe e konsideronte ndër ma të vjetrat që jetojnë, në botë. Kjo thoshte, shifet sepse ka shumë fjalë njirrokëshe."

Rozar Dodmasej, (1912), agronom, Shkodër, ish student i Mjedës: "*Më ka mësue shqip dhe histori në klasë të dytë dhe të tretë të liceut në Shkodër. Shqipen e zhvillonte në rang universiteti. Për mjaft çeshtje thoshte se për këtë kam bisedue me Joklin, ose mendimi i Meyer-it asht ky. Mandej jepte mendimin e vet. Mezi ç'prisnim me ardhë ora e tij. Na lente me gojë hapët. E përcillte leksionin me shembuj interesantë. Jepte etimologjinë e fjalës. Jepte edhe lidhjen në plan krahasues me gjuhët e tjera.*"

Ernest Koliqi (Dom Ndre Mjedja, Cika, v.2, nr. 28-29, fq. 202, Shkodër, 5 shtator 1937.): "*Po t'ishte qënë Dom Ndreu vetëm nji erudit mbledhës citatash klasike apo vetëm nji ligjerues i hollë mbi systemet e ndryshme filozofike, vepra e tij sigurisht do të kishte humbun me tê. Nji tjetër gjâ e bâni të Madh e të padekëshëm: dashunija e stërfuqishme për gjuhë shqipe. Ai njoftës i rrallë i gjuhve të vjetra, ai qi shkruente mjeshtrisht pesë gjuhë të mëdhaja europjane dhe lexonte e kuptonte njâ tri a katër tjera, dashunonte me nji dashuní të njomë e luftarake këtë gjuhë të palavrueme t'onë. E dashunonte si Dijetar e si Atdhetar, e dashunonte edhe si Poet. Shkrimtarët e moçem gegë e toskë dhe italo-shqiptarë i studjonte pajadá dhe dinte këthelltas historín e çdo fjale të shqipes. Ai i vetmi ndër ne, po të kishte dashun, mund të përpilonte nji fjaluer historik të gjuhës, sepse përveç përdorimit të saj në popull dhe ndër tekste letrare njifte mirfilli edhe burimin ethimologjik. Ndoq përherë me vërejtje studjimet e albanologve dhe mbajti letër-shkembim të vazhdueshëm me Pedersenin, Joklin, Tagliavinin. Qe në riní dishepull i Gustav Mayerit. Mjerisht shum pak prej vërejtjeve të shumta, qi ai përmblodhi në këto studjime të parreshtuna, Dom Ndreu botoi. Ai shpërndante dijen e vet në gjuhësí ndër këshille miqve, nxânësvet, kujdo qi i siellej. Auktorë fjalorësh e shkrimtarë të vjetër e të rij (ndër të cilët edhe unë) i detyrohen ndihmës së tij zêmër-bardhë për spjegime, ndriçime, qortime e shllime. Ai epte landen e vet të grumbullueme me vishtirsí, i knaqun kur dikuj i hŷnte në punë për naltësim të shqipes e të Shqipnís*".



FISHTA NË FOKUSIN E STUDIUESIT TONIN ÇOBANIT

Kohëve të fundit është shtuar numri i studiueseve, të cilët në mënyre profesionale janë duke u marrë me jetën dhe veprën e At Gjergj Fishtës. Pas, Pal Duka- Gjinit (At Danilel Gjeçaj) na la një monografi të zgjeruar, ndërsa në vazhdën e studiuesve të sotëm nga Shqipëria, që kanë shkruar libra vlerësues për poetin, ndër të tjerë do veçonim: Stefan Çapaliku, Persida Asllani, Lili Sula, Blerina Suta dhe Tonin Çobani.

Studiuesi me i spikatur, i cili la gjurmë të dukshme, në zbërthimin e veprave artistike dhe letrare te Fishtës është, Dr. Tonin Çobani. Ai, punën e tij shumëvjeçare për Fishtën, e kurorëzoj me dt. 12 nëntor 2011, duke mbrojtur temën e doktoraturës "**Ngjizja mitologjike e Lahutës së Malcis".** Mbrojtja e temës u zhvillua, në Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë me juri: prof. dr. Enver Muhametaj, Drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (Kryetar), prof. dr. Shaban Sinani (oponent), prof. dr. Alfred Çapaliku (oponent), prof. as. dr. Ledri Kurti (anatar), prof. as. dr. Tefë Topalli (anatar); udhëheqës i doktoraturës, prof. dr. Stefan Çapaliku; vlerësimi: 99 pikë nga 100 të mundshme.

Tri pyetje autorit

1. Pyetje: Çfarë përmban teza e doktoraturës suaj "Ngjizja mitologjike e Lahutës së Malcis"?

Dr. Tonin Çobani: "Ngjizja mitologjike e Lahutës së Malcis" është një studim i fokusuar në lëndën mitologjike të veprës madhore *Lahuta e*

Malcis të Gjergj Fishtës. Ngjizja mitologjike ka të bëjë me fillesën mitologjike të veprës, si dhe me endjen mitologjike të subjektit, që vjen si një gërshetim paralel me bëmat e heronjve shqiptarë në të gjitha episodet. Ngjizja mitologjike lidhet, gjithashtu, me figurat mitologjike në *Lahutë të Malcis*, me marrëdhëniet e tyre me heronjtë realë të veprës, me mjedisin ku ato veprojnë dhe mentalitetin e tyre, si dhe me frymën e përgjithshme të veprës.

2. Pyetje: Ç'vend zë studimi i juaj në gamën e studimeve të deritanishme për *Lahutën* e At Gjergjit?

Dr. Tonin Çobani: Studimet e deritanishme mbi *Lahutën e Malcis*, duke qenë përgjithësisht përshkruese, kanë rrahur të evidentojnë heronjtë realë të *Lahutës së Malcis* në përballje me kundërshtarët: pasqyrimin epik të tyre në përqasje me heronjtë e Eposit të Kreshnikëve, poetizimin në vargje tetërrokëshe të historisë sipas gjellëve folklorike etj. Studime të tilla janë mjaftuar në përmendjen e qenieve mitologjike, të cilat veprojnë përkrah heronjve, pak a shumë, si perënditë e Olimpit në veprat homerike apo virgjiliane. Të gjitha këto dëshmojmë për një studim shkencor të munguar të mitologjisë në veprën madhore të Gjergj Fishtës, *Lahuta e Malcis*. Shqyrtimi i figurave mitologjike dhe i ngjizjes mitologjike të *Lahutës së Malcis*, jep një përgjigje tjetër për sa i përket heroit qendror në atë vepër: është Zana e Frymëzimit, e cila, duke i qëndruar përkrah autorit në të gjitha episodet e *Lahutës,* kthehet edhe në personazh kryesor. Ajo merr pjesë në të gjitha këngët e *Lahutës* si narratore e gjithëdijshme, por edhe vepron, ashtu si Dragonjtë luftojnë, si Orët punojnë si sojnike, Shtrigat përleshën me Orën e Shkjeve etj. Përgjigje të tjera do të mund të marrin edhe probleme që lidhen me folklorizmin e shumëpërfolur të *Lahutës së Malcis* dhe formën artistike origjinale të kësaj vepre.

3. Pyetje: Mund të na thoni shkurtimisht cila ka qenë përqasja e juaj me mitologjinë në veprën At Gjergjit?

Dr. Tonin Çobani: Analiza e tekstit të Lahutës ka qenë metoda sunduese për këtë studim**.** Domethënë, janë parë figurat mitologjike një nga një në raport me të gjithë veprën: Zanat, Orët, Dragonjtë, Floçkat, Lugetërit, Shtrigat, Ulkonjat etj. Më tej janë shqyrtuar në marrëdhëniet e tyre personazhet mitologjikë të individualizuar në *Lahutë të Malcis*: janë gjithsej

111 figura mitologjike, 90 prej të cilave me emra të përveçëm, si p.sh., Zana e Veleçikut, Ora me emrin Dake, Dragoi me emër Lleshi i Zi, Shtriga me emër Pasuta etj. Rezultat i kësaj pune është krijimi i fjalorit të figurave mitologjike (kapitulli i parafundit i këtij studimi) ku janë përfshirë edhe disa toponime që lidhen me këto figura.

Krahas metodës së analizës, mbizotërues ka qenë edhe krahasimi emër për emër dhe sipas grupeve i figurave mitologjike të *Lahutës së Malcis*, me figurat mitologjike të folklorit shqiptar, si dhe me pasurinë mitologjike të Mesdheut e më gjerë, respektivisht me mitologjinë greko-romake, mitologjinë sllave, mitologjinë anglosaksone e italike. Me mjaft vëmendje ngjizja mitologjike e *Lahutës së Malcis* është ballafaquar me modele të njohur të veprave epike të autorëve të tillë, si: Homeri, Virgjili, Miltoni, Vagneri etj. Këndej burojnë përfundimet se Fishta nuk i ka marrë figurat mitologjike ashtu si ata gjallonin në folklor: ai i ka rikrijuar në përputhje me përfytyrimet popullore, ndoshta, duke ndjekur shembullin e Vagnerit që rikrijoi eposin kombëtar të gjermanëve, Nibelungët (është fjala për tekstin e operës me të njëjtin titull, kompozuar po prej tij) në përputhje të plotë me mitologjinë gjermanike.

Sigurisht, për të arritur në përfundime shkencërisht të argumentuara, analiza dhe krahasimet janë përvijuar me shqyrtimin e tekstit në marrëdhënie me faktet biografike të autorit, pasi vepra është shkruar në një periudhë të gjatë kohore. Në kapitullin e parë shpjegohet historia e krijimit të *Lahutës së Malcis*, e cila ka shërbyer si shtrat për të zbuluar hap pas hapi si është krijuar ngjizja mitologjike e asaj vepre qysh në dy blenet e para (botuar më 1904/5-1907) deri në këngën e fundit ("Koha e Re") që e pa dritën e botimit ë vitin 1937, kur u publikua vepra e plotë, *Lahuta e Malcis*. Një kapitull i kushtohet "Zanave dhe Orëve" (kapitulli II), të tjerët: "Dragonjve" (kapitulli III), "Floçkës" (kapitulli IV), "Lugetërve dhe Shtrigave" (kapitulli V), Fjalorit të figurave mitologjike (Kapitulli VI) dhe i fundit përfundimeve (kapitulli VII).

Disa nga veprat e Dr. Tonin Çobanit :

I. Monografi shkencore:

1. *"**Princi i përfolur Lekë Dukagjini",** monografi (resume anglisht), Tiranë, 2003.*

2. *"**Frang Bardhi dhe relacionet e tij",** monografi, Zagreb, 2006.*

***3. "Pjetër Zarishi dhe Krijimi i rruzullimit",** monografi, Tiranë, 2007.*

***4. "Figurat Mitologjike në Lahutë të Malcis",** monografi (resume anglisht), Tiranë, 2008.*

***5. "Nënë Tereza, nderimi në trevat shqiptare",** album (shqip-anglisht), bashkautor, Prishtinë, 2010.*

II.Përmbledhje me studime:

***6. "Kërkime letrare"**, studime dhe kritika letrare, Tiranë, 1988.*

***7. "Miti dhe antimiti fishtjan"**, dhjetë ese për Fishtën, Tiranë, 1999.*

8. *"**Paralele kulturore të një qyteti",** artikuj dhe studime, Lezhë, 2001.*

9. *"**Fishtologji**", studime, Tiranë, 2006.*

III.Fiction etj.

***10. "Puthje pa puthje**", tregime, Lezhë. 1996.*

11. *"**Një grua përballë vetvetes",** novelë, Lezhë, 1997.*

12. *"**Etyde në prozë, gjashtë triptikë",** tregime, Tiranë, 2002.*

13. *"**Variacione me fjalën komb**", eseistikë, Tiranë, 2004.*

***14. "Lezha – guidë"** (bashkautor), shqip dhe anglisht, Tiranë, 2002.*

***15. Gjergj Fishta "Vepra letrare"** në 10 vëllime (botimi i parë: 2001, botimi i dytë: 2011), kryeredaktor (vëll.7,8 (dramatika) edhe përgatitur për botim dhe pajisur me pasthënie).*

Kastriot Marku
Milot

Nismëtari i shkollës letrare françeskane të Shkodrës

At Leonardo De Martino O.F.M. (1830-1923)

Me rastin 130-vjetorit të botimit (1881-2011) të përmbledhjes poetike "L'Arpa d'un italo-albanese". Tip. dell'Ancora, Venezia 1881, f. 442.

Tashmë është bërë i njohur përmes studiuesve françeskanë, kryesisht At Marin Sirdani dhe At Vinçenc Malaj, por edhe nga shumë studiues të tjerë, roli i madh që ka luajtur Urdhri Françeskan në Shqipëri për ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturës dhe traditave shqiptare përgjatë pesë shekujve të sundimit osman dhe më vonë përreth pesë dekada të sundimit komunist. Përhapja e shkollimit në gjuhën shqipe, botimi i teksteve në këtë gjuhë, krijimi i bibliotekave, arkivave, muzeve, teatrove, bandave muzikore, shoqërive kulturore, fetare, teatrore e muzikore, ndërtimi dhe krijimi i një rrjeti të tërë shkollash, kolegjesh, instalimi i shtypshkronjave, botimi i periodikëve etj, janë vetëm disa nga veprat e shumta të krijuara nga etërit e zhgunit serafik të Shën Françeskut të përvuajtur të Asizit.

Natyrisht që studimet dhe kërkimet për historinë dhe veprën e këtij Urdhër nuk kanë qenë të plota, por duhet të përthellohen, duke bërë objekt kërkimi jo vetëm të dhënat gojore, por mbi të gjitha dokumente, dorëshkrime e burime arkivore që ruhen si në arkivin e Urdhrit Françeskan, ashtu edhe në arkiva e në biblioteka të tjera të urdhërit, kryesisht në Itali, Bosnjë, Kroaci por edhe në Austri e në ndonjë vend tjetër, kur qoftë për shkak të varësisë së Urdhërit, qoftë për shkak të shkollimit të disa prej përfaqësuesve më të njohur të kësaj kësaj Province, mbetet të nxirren në dritë fakte të panjohura si përplotësim i një historie të plotë të këtij urdhëri emërmadh në historinë dhe kulturën shqiptare.

Kontribut të veçantë për Urdhrin e Françeskanëve në Shqipëri kanë dhënë po ashtu vëllezërit misionarë ardhur nga Provincat motra të Urdhërit kryesisht italianë të cilët ndanë fatin e tyre me popullin shqiptar.

Mjafto të përmendim disa prej tyre sikurse: At Leo da Citadella i cili thuhet se la në dorëshkrim veprën: *Dictionarium epiroticum*. 1671; Bernardino Quintiano. *Dottrina cristiana epirotica*. 1675; Francesco Maria da Leçe. *Osservazioni gramaticali nella lingua albanese*. Propaganda Fidae, Romë, 1716; *Il Dittionario italiano-albanese (1702)*. Botim kritik me hyrje dhe fjalësim shqip përgatitur nga Gëzim Gurga. Botime Françeskane, Shkodër, 2009; Didaco da Desio. *Grammatica albanese*. 1722; Onofrio. *Akte pagëzimi*. 1739;



Bonaventura Prucher. *Manuale catechistico italiano-epirotico*. 1752; Dario Bucarelli. *Udha e Sceites Cryc e tiera pun'divocme. Scruem prei gni Frat t'Sceitit Isc'Francescut*. N'Rom. Me stampen t'sceitit Cuvend, ci munohet me apun feen. 1862; *Dotrina e kscten. Mbledhun n'pac fial. Per hyzmet t'Arkidiecesit e Scups prei F. D.B.M.O.M.A*. N'Sckoder. Me Sctamp t'kollegs t'Sccyniis ci âsct nen Scêitin At Pap. 1877. *Grammatica della lingua albanese*, 1862; Francesco Rossi da Montalto Ligure. *Vocabolario Italiano-Epirotico con tavola sinottica compilato dal Padre Francesco Rossi da Montaldo Ligure min. oss. Riform dell' alma provincia omana exprefetto apostolico delle misioni di Servia*. Roma, Stamperia della S. C. De Propaganda Fide, amministrata dal socio cav. Pietro Marietti, 1866; *Vocabolario della lingua epirotica-italiana, compilato sui vocabolari Tanfani, Trincheri ed altri con tavolo sinottica*. Roma, 1875; *Regole grammaticali della lingua albanese: compilate sulle traccie di buoni grammatici e del p. Francesco M. da Lecce Min. Osserv. Riform.* Roma : Stamperia della S. C. di Propaganda Fide, 1866; Tommaso Marcozzi da Rapino. *Kempis o sikur calzoni t'diiscmit/Giovanni Gersen/ T'perghiaamit e Jezu Krisctit. Kthye schiyp*

prei P. Toms Marcozzit M.O. Miss. AP. N'Rom. Me sctamp t'Kuvenit t'S. Propagand. 1881; *Muj i Majit sciuguruem Zois Beekueme, goditun scciyp prei P. Toms Marcozzit M.O.M.A*. Sctampuem per cialltii t'Fretenve t'Scêitit sc'Francesk [Shkodër] Miss. N'senne. 1882. Francesco Melchiori da Bieno. *Sulet e regula e vlasenvet e t'motravet t'tretit urdhen t'Scheitit Sc'Francesk prej Asizit mas emrenameve e mas lirimeve t'reja t'sceitit At Pap. Leonit XIII*, Sckoder, 1816. Me Sctamp t'Kolegs Papnore, 1896.

Por këtu është rasti të flasim pak për një misionar pak të veçantë, për At Leonardo de Martinon, françeskanin arbëresh me gjak shqiptari, i cili kthehet misionit të pamundur të të parëve të tij pas 4 shekujsh për shkak të pushtimit osman.

At Leonardo De Martino O.F.M. (1830-1923), lindi më 1830 (thuhet në ndonjë rast edhe më 05.03.1840), në Greci të Campangno-s, nga prindërit Leopoldo dhe Elisabeta, në një familje fisnike të një katundi arbëresh ky, sot përfshirë në krahinën e Avelinos (Itali). Mbasi veshi petkun e Shën Françeskut ndoqi studimet në Kolegjin e Shën Bartholomeut në Isola. Në Shqipëri erdhi si misionar në vitin 1865, dhe për rreth dyzetë vite qëndroi këtu, në fillim në Shkodër e më pas në dioqezën e Pultit dhe atë të Lezhës. At Leonardo De Martino mund të themi me plot gojën se ringjalli rishtas jo vetëm veprimtarinë kulturore dhe fetare të françeskanëve, por në anën tjetër u shndërrua edhe në një pikë referimi të rëndësishme për ringritjen politiko-shoqërore, falë bashkëpunimit me Italinë përmes mikut të tij politikanit të njohur arbëresh Francesco Crispi-t (1818-1901). Veprimtaria e tij fetare dhe atdhetare gjeti përnjëherë përkrahjen e dy themeluesve të Shkollës së Motrave Stigmatine të Shkodrës, misionarëve françeskanë: At Gianpiero nga Bergamo, pro-prefekt apostolik i françeskanëve të Shkodrës, At Mariano nga Palmanova dhe nga pro-prefekti i Epirit, At Bernardini nga Portogruaro, Ministri Gjeneral i Urdhërit.



Me nismën e të parit, De Martino u shndërrua në mbështetësin kryesor të themelimi të shkollës së motrave Stigmatine në këtë qytet. Katër Religjioze Terziarie të njohura si Stigmatine, të kryesuara nga Madre Suor Bonaventura, ish-superiorja e madhe e Institutit, kishin ardhur nga Firence më 2 qershor 1879, ku kishin studiar për pesë vjet me radhë dhe atyre iu bashkuan motrat Marjana Gera dhe Konçeta Kurti, të cilat pasi blejnë për Institutin e tyre shtëpinë e një të moshuare të njohur si Shtëpia e Koprraces, hapin aty të parën shkollë femërore.

De Martino së bashku me shkrimtaren Dora d'Istria (Elena Gjikën), me të cilën mban lidhje të ngushtë, mbajnë prioritet të tyre edukimin e vajzave shqiptare, të cilat deri në atë kohë nuk e njihnin arsimimin dhe jetonin në injorancë të thellë. Ai në emër të treqind vajzave shqiptare të nënshkruara i dërgon Elena Gjikës një pendë të punuar në filigram shoqëruar me pershëndetjet më të perzemërta për kontributin e saj. De Martino po ashtu njihet edhe si bashkëthemelues i shkollës françeskanëve në Shqipëri (1861). Gjatë shërbimit të tij baritor, ndërkohë që mbulonte me detyrë kishtare dioqezat e Zadrimës dhe të Lezhë, mësoi me zell të madh dialektin geg, kryesisht variantet e të folmeve të zonës përreth Shkodrës dhe kësisoi ai filloi të shkruaj në këtë dialekt.

Natën e Krishtlindjes së vitit 1880 u shfaq në shkollën françeskane drama e shkruar prej tij *Nata e këshndellavet*. Për shumë kohë ai përveçse kryente punën e mësuesit, për njëfarë kohe qe sekretar i princit të Mirditës Preng Pashës si dhe mësues (kujdestar) i djalit të tij Preng Bib Dodës. Në Kuvendin e Troshanit, ku edhe jepte mësim, ai shkroi shumicën veprës së tij letrare. Në fillim nisi me përkthimet e poetëve lirikë italianë. Më 1868 përktheu poezinë e T. Grossi-t: *Vaji i hapses*, të cilën ia kushtoi Dora d'Istrës. Vitin vijues përktheu një pjesë të *Himneve të pershpirtshme* (Këshnellat) nga A. Manzoni, më 1869 botoi parafrazën e *At'ynës* e të *Falemi Mris* e *Dekalogun*, ndërsa më 1875 përktheu *Via Crucis* nga Metastasio, duke dëshmuar kështu një tjetër anë të veçanë të talentit të tij sikurse ishte përkthimi. Ishte një ndër themeluesit e tingëllimës e të dramaturgjisë në shqip.

Veprat e tij kryesore janë: *Il lamento della prigioniera* di Tommaso Grossi. *Vaji i hapses shqyp*. Lloyd Austriaco, Trieste,

1868; *L'Arpa d'un italo-albanese*. Tip. dell'Ancora, Venezia 1881, në të cilën është përfshirë edhe teksti dramatik *Nata e kështndellavet*, e cila u vu në skenë në Shkodër më 1880; *Arbenorve t'kersctén t'Grisciun Festuér*. Shkodër 1896; *La questione albanese orientale e la nuova crociata. Poemetto eroicomico popolare*. Laterza e Figli, Bari 1897. Një vit pas botimit të vëllimit poetik, më 1882 rikthehet në Itali, për nder të të cilit bashkësia arbëreshe e Greçit i organizoi një pritje të veçantë, ku pjesë e kësaj pritjejej u bë edhe bashkia, e cila botoi: *Il Leone d'Albania festeggiato in Greci*. Vdiq në një kuvend françeskan në periferi të Napolit më 12 korrik 1923 në moshën 93 vjeçare.

Shkolla letrare françeskane e Shkodrës pati si nismëtar të saj pikërisht At Leonardo De Martinon. At Leonardo De Martino sipas Ernest Koliqit ishte: "*...paraprisi i asaj levizje ndër letrat t'ona qi muer shembull e frymzim nga pasunija shprehëse popullore*." Ndërsa sipas Filip Fishtës ai "*...u bâ shkollë për nxânsit e tij të shkëlqyeshëm si për Auktorin e Lahutës së Malcis e tjerë*.." për të cilin jo vetëm ishte ai që e pagëzoi dhe e mori dhe e futi në shkollë, por qe njëherësh edhe mësuesi që i dha mësimet e para mbi vjershërimin. At Zef Pllumi me të drejtë do ta konsideronte si: "*prijsi i formacionit kulturor të françeskanëve shqiptarë*". Nëse do të na duhej të shënonim si kufi kohor të veprimtarisë letrare të kësaj shkolle, natyrisht që ai do të vendosej në vitin 1881, vit kur del përmbledhje e De Martinos *L'Arpa d'un italo-albanese*. Tip. dell'Ancora, Venezia. Me këtë vepër nis tradita poetike, në kuptimin e mirfilltë artistik të fjalës, sepse ai diti të shartojë bukur e me finesë trajtat poetike shqipe sipas metrikës italiane.

Sipas Ernest Koliqit, De Martino: "*...dha një provë të mundësive poetike të shqipes me vargjet e tij të kalituar mirë, herë me shprehje të kulluara popullore, herë me ton të ngritur klasik, modeluar mbi shembujt e shumëllojshëm të metrikës italiane. Vepra e këtij poeti italo-shqiptar që shkroi në një gegërishte të përsosur, nuk është vlerësuar ende në masën e duhur. Disa lirika të tij shquhen për cilësi prej mjeshtrash të vërtetë. Kjo vepër, me ndikimin e saj të frytshëm, ka qenë vendimtare në përcaktimin e drejtimit të letërsisë shkodrane. Aty, fryma dhe format klasike e popullore janë shkrirë në një simbioze harmonike. Orvatja e suksesshme e De Martinos në përdorimin e shqipes nëpër krijime me frymëzim dhe lëvizje elegante klasike i dha shkas mësimeve të Xanonit, që, i ndjekur nga një aradhë letrarësh te rinj krijoi njërën na dy shkollat shkodrane. Kjo shkollë lindi dhe u zhvillua në mjedisin e institucioneve të rrepta të etërve jezuitë. Kështu nisi në Shkodër një fazë e frytshme e letrave shqipe e cila kulmon me kryeveprën lirike të Gjergj Fishtës dhe me lirikat e mahnitshme të Ndre Mjedës*." Tek ai gjejmë së pari sonetin me bisht (*sonetto codato ose sonettessa*), të cilin e gjejmë në poezinë e shkruar më 1875 *Ma e madhja dit'motmotit prap mrrini*, poezi kushtuar Imzot Pjetër Severinit, tek i cili shërbente si sekretar, që paraprin përkthimin e *Via Crucis* të Metastasio-s, si dhe mjaft shembuj të shumëllojshëm modeluar sipas metrikës italiane. Poezia e tij epasuroi letërsinë tonë në formë. Prozodinë shqiptare u pasurua me mjete të reja: me vargje jambike dhe trajta të ndryshme strofike. Jo pa qëllim, por jo krejt falë miqësisë personale, por falë përvojës poetike që solli në poezinë e asaj periudhe, atij i kushtojnë në shenjë nderimi dy tingëllima Ndue Bytyçi dhe Filip Shiroka. De Martino po ashtu qe ndër të parët që lëvroj dramën shqipe, dhe i pari dramën baritore të përshpirtshme me tekstin e botuar tek *Harpa* me titullin: *Nata e kështndellavet.* Një fakt mjaft interesant për kërkimet mbi këtë personalitet kulturor dhe letrar me peshë në veprimtarinë letrare jo vetëm françeskane, por edhe më tej është prania e tetë njësive bibliografike (botime dhe dorëshkrime) nga gjithsej shtatëmbëdhjetë të tilla, në bibliotekën personale të shkrimtarit të njohur italian *Giozue Carduci-t* me emrin *Casa Carducci* në Bolonja.

Ndue Dedaj
Rreshen

At FABIAN BARKATA, MISIONAR DHE SHKRIMTAR AUSTRIAK -Profil humanisti europian -

Fabian Barkata Barcatta (1868-1954) misionar françeskan austriak, shkrimtar, artist, dijetar, ka shërbyer në Shqipëri për dhjetë vjet, nga viti 1895 - 1897 dhe 1899 - 1907. Autori i romanit të mirënjohur "LULE" (botuar për herë të parë në gjermanisht, Mynih 1924 dhe në shqip nga "Nikaj" me 1930, përkthyer nga profesori i shquar i letërsisë Karl Gurakuqi) si dhe i disa novelave e historive kushtuar shqiptarëve. "Ditari im Shqiptar" është një tjetër vepër e Barcatës që u botua, për herë të parë në shqip, nga shtëpia botuese "Mirdita" në vitin 2005. Ai u shkrua me 1905-1906 në Kryezez (Rubik) dhe u botua njëzet vjet më vonë në revistën françeskane Franzisziglöcklein Austri, në vitet 1926-1927. Sa dimë, është i pari ditar i mirëfilltë i një të huaji për Shqipërinë. Përkthimi nga gjermanishtja i "Ditarit" është bërë me përkushtim nga Angjela Luka, Shkodër, nën kujdesin e Lidhjes Kulturore Austri Mirditë (KÖM), me kontributin e veçantë të Padër Franz Winsauer-it, nga Dornbirni (Austri).



Barcata, autori pak i panjohur i një vepre të mirënjohur, romanit "Lule", pasi do të shkëlqente si meteor në qiellin letrar-kulturor dhqiptar të viteve '30, do të shuhej për dhjetëra vjet. Tash shohim se bibliogafia e tij krijuese plotësohet jo vetëm me "Ditari im Shqiptar", novelat e historitë, po dhe punët në skulpurë, pikturë, muze, gjithkund nëpër tempujt e Shën Françeskut etj. Dora e tij prej mjeshtri të talentuar dekoroi dhe manastiret e Austrisë, dhe kishat e Amerikës, dhe ato të Rubikut e Kallmetit në Shqipëri.

Françeskani i vjetër austriak "më shqiptar se shqiptari"

Fabian Barcata na shfaqet si një interpret i rrallë i shpirtit dhe mendësisë së shqiptarëve të Veriut, i dokeve, riteve, besëtytnive, traditave, virtytit të njerëzve të këtij vendi, me të cilët ai u shkri si rrallëkush i huaj. Ai ishte frat dhe shkrimtar, artist dhe dijetar, shërues dhe ditarmbajtës. Një figurë befasuese humanisti europian.

Ai iku një ditë, por Mirditën e mori me vete nën zhgunin e tij prej françeskani të paepur. Kryezezi gjithnjë flinte dhe zgjohej në ndërgjegjen e tij, si një peng i pakryer asnjëherë, për shkak të shëmbëlltyrave njerëzore, kujtesa e të cilëve nuk mund të shuhej kurrë tek ai. Iku për t'u rikthyer (përmes botimesh e ribotimesh) pas njëqind vjetësh, si nga një legjendë e përhumbur, gjithherë "lajmëtar i çdo fjale fatlume", siç do të thoshin vëllezërit e tij françeskanë të manastirit të Schwazit e Halit. Ai pati ardhur në Shqipëri për të predikuar ungjillin, por dhe për t'i shëruar njerëzit nga sëmundjet dhe besëtytnitë, për t'i pasuruar shpirtërisht. Por ai dhe mori për vete nga mirësia e këtyre njerëzve, siç e thotë sa herë në ditarin e tij. Ata i dhanë fuqinë dhe mahnitjen për ta kuptuar më mirë botën e pakufishme të njeriut. Njëherësh, ai nuk mund të rrinte pa e çuar misionin e tij deri në fund dhe si shkrimtar, dmth që t'i shkruante dhe ku e ku t'i botonte historitë e tyre "prej kohës së kalueme të Shqipnisë", ndërthurur në "ligje dhe zakonte të vjetra në malet shqiptare." Duke përmendur "Kumbona e thyeme", "Gjaku i falun" dhe sidomos "Lule" të At Fabian Barcattes, historiani i njohur, akademiku Zef Mirdita i konsideron këto vepra "me rëndësi për njohjen e zakoneve ndër mirditorët."

Shëmbëlltyra e një njeriu të pazakontë

Në gusht të vitit 1906, inxhinieri austriak Karl Steinmetz (pasi bën një vizitë të shkurtër në kishën e Velës, një godinë e thjeshtë e pa stoli, ku e pret miqësisht Dom Mark Negri, ashtu siç e kishin zakon klerikët katolikë të Shqipërisë së Veriut) mbërrin në famullinë e Kryezezit. Para tij shfaqet pamja e pazakontë e misionarit, siç e cilëson ai. "Mustaqe tepër të gjata, me të cilat do të krenohej çdo oficer kusarësh, i bënin hije gojës ku rrinte një pip i shkurtër. Kokën ia mbulonte një kapele e vjetruar, dhe vetëm petku françeskan i dalë boje, tregonte cili ishte ai burrë. Ishte At Fabian Barcata, një tirolez që tash sa vjet

punon në Shqipëri... At Fabiani, një tirolez i vërtetë, i ndershëm dhe i çiltër, i cili çdo gjë që ka e ndan me besimtarët e tij, zotëron një kulturë të gjerë, sidomos në shkencat natyrore është mjaft i përgatitur. Çdo gurë e çdo bimë është e njohur prej tij në rajon. Nga larg vijnë të sëmurët për të kërkuar ndihmën e famullitarit të Kryezezit, i cili zhvillon një aktivitet mjekësor të dobishëm në sajë të njohurive dhe të një rezerve të pasur ilaçesh". Dr. P. Josef Leon. Steindl, shkruan: "Në Shqipëri Padër Fabiani u bë dhe mjek. Kushtet në vend e ngutën për një gjë të tillë. Me sëmundjet e komplikuara nuk përzihej, por ato të zakonshmet mësoi t'i kuronte me ilaçe. Kur në Kryezez u paraqit një rast lije, ai duke parandjerë rrezikun e një epidemie, shkoi menjëherë tek konsulli austriak në Shkodër me lutjen që të siguronte një vaksinë nga Vjena. Meqë konsulli nuk mundi t'i jepte asnjë mjek me vete, At Fabiani iu përgjigj: "Unë do t'i vaksinoj vetë njerëzit". Falë ndërhyrjes energjike të tij, në Kryezez epidemia e zezë thuajse u shmang, vdiq vetëm një fëmijë, ndërkohë që në një komunë fqinje njëzet njerëz u rrëmbyen nga epidemia. Ai si një mjek popullor përpunonte vetë ilaçe të thjeshta po të forta, prej bimëve të mbledhura si biolog nëpër shpatet e Molungut e Velës. Në një rast, kur ai pati sukses të plotë në shërimin e një gruaje që vuante nga kriza të forta si pasojë e një frike,

në ditarin e tij shënoi: "Zoti im i dashur, ti je kaq i mirë me ne njerëzit". Shumica e të sëmurëve vdisnin nga mungesa e mjekut, ilaçeve dhe kujdesit shëndetësor, ku priftit i duhej të jepte zgjidhje për shumëçka, sa ai të befason kur thotë "në dhomën e të vdekurit mora vendimin për t'u bërë vetë mjek". Për të nuk është e huaj asgjë që lidhet me fatin e famullisë së tij. Fretërit shpesh bënin dhe punën e mjekut, infermierit, si murgeshat e Kallmetit, gjithashtu austriake. Kjo të sjell ndërmend shembullin e *fratit të pashallarëve të Shkodrës*, At Erasmo Balneo-s, portretizuar me aq mjeshtri nga At Zef Pllumi në një libër të tijin të kohëve të fundit.

Fëmijët ishin pasioni i At Fabianit. Të vegjlit e Kryezezit i ishin tepër mirënjohës famullitarit, që ishte kujdesur me aq sakrifica për shëndetin e tyre, dhe jo vetëm për atë shpirtëror.

Një "porosi" nga Shqipëria për qytetërimin evropian

Jemi mësuar t'i kërkojmë kumte dhe modelet e qytetërimit në Evropë, por Fabian Barcata, frati nga Tiroli i Jugut, pasi ka bërë vetë jetën e maleve, pasi ka zbuluar një botë të përveçme në qetësinë e saj olimpike, pasi ka prekur "shpirtin" e trazuar të këtij vendi, përmes romanit të tij "Lule", ai iu drejtohet evropianëve, si me gjuhën e një kambane:

"Këtu, këtu, në Shqipni, duhet të vijnë të gjithë edukuesit tuej të popullit, tue fillue prej profesorëve të universiteteve, që nuk shofin përtej hundës së vet, deri te klasat krenare të mësuesve, të cilët zanë vendet në shkollat popullore me dam të njerzimit; këtu po, në Shqypni, të vijnë demagogët dhe lumteniprusit tuej, të gjithë anarkistët e vendeve tueja, komunistët dhe socialistët, zejtarët e puntorët tuej, qytetarët e katundarët, të gjithë elementet e pakënaqun, të mdhajt dhe të vogjlit. Këtu, po, pranë këtij populli të thjeshtë e të paprishun, te këta njerëz, që ata i quejnë gjysmë barbarë, duhet të vijnë në shkollë e të nxanë, se si në vobegsi, në thjeshtsi andjesh, në shpresë te i madhi Perendi, e ka rrajën lumnia e çdo njeriu, veçanërisht, dhe gëzimi e mirërrotja e popujve përgjithësisht. Këtu në Shqypni, do të gjejshin të gjithë shkollën e naltë të vërtetë të jetës."

At Maurici (personazhi autobiografik) këto fjalë i vë në gojën e At Anastazit, famullitarit të Kryezezit, që "nuk e kishte zakon me folë shumë, por kur flitte, fjalët e pakta, por të matuna të tija, ishin në gjendje me ta mbushë mendjen, me t'entuziasmue, me të prekë mu në thalb të zemrës." Kur ishte i ri, At Anastazi kishte qenë profesor në një fakultet të Romës, që tregon klasin e tij si intelektual evropian, por që nga qëndrimi dyzet vjet në Shqipëri "*ishte ba ma Shqiptar se Shqiptari*." Ky pra kritikonte pa prà e me theksim *"kulturën moderne europiane, e cila ishte tue ra për ditë e ma poshtë..."* Ky misionar i vjetër, si dhe vetë At Maurici i ri, kishin një qëndrim mjaft kritik për zhvillimet e asokohshme në Evropë, për shkollën dhe dituritë *"krenare e marroçe"*, artet që *"kishin dalë jashtë rrugës së drejtë"*, *"për gjendjen e keqe shoqnore"*, *"përparimin gjysmak të padurueshëm"*, *"njerëzinë e mjerë e të pa karakter."* Të dy këta misionarë, At Anastazi dhe At Maurici, kishin mësuar gjuhën shqipe dhe flisnin shqip dhe kur ishin vetëm për vetëm.

Biografi e shkurtër e Fabian Barcatës

Fabian Barcata u lind në Valfloriana (Fleimstal) në Jug të Tirolit, Austri me 29 mars 1868. Emri i tij i pagëzimit ishte: Moritz.

U vesh me uniformë fetare me 25 gusht 1885. Merr emrin e rregulltarisë Fabian.

Shugurohet prift me 3 maj 1891 dhe emërohet në Brixen e Graz.

Me 30 nëtor 1893 deri me 6 gusht 1894, në Maria Lankovitz, shërben si lektor i klerikëve shqiptarë.

Me 1894 punon sërish në Graz si lektor i lëndëve të gjimnazit.

Vjen në Shqipëri, misionar françeskan, në Kryezez (Rubik) të Mirditës me 1895 ku qëndron dy vjet deri me 1897.

Vitet 1897-1898 i kaloi në Innichen. Në vitet 1898-1899 është sërish në Graz si ndihmës i përkohshëm.

Kthehet në Shqipëri, tashmë si famullitar i Rubikut, me 1899, ku qëndron 8 vjet deri me 1907. Pak kohë ka qëndruar dhe në Shkodër e Lezhë.

I kërcënuar nga sëmundja e malaries, kthehet në vendlindje, në Provincën Françeskane në vitin 1907.

Në vitet në vazhdim Barcata shërben në Kaltern, Bozen, Vallach dhe përsëri në Bozen, qytet ku ai zhvilloi veprimtarinë e vet.

Nga fundi i Luftës së Parë Botërore përfundoi në burg, prej nga doli me 8 prill 1919.

Për dy vjet qëndroi si ndihmës i përkohshëm në Kaltern dhe Bozen.

Më pas përmbi 30 vjet (nga 1922 deri me 1954) At Fabian Barcata shërbeu në SCHWAZ. Në këtë kohë bie veprimtaria e tij e pasur artistike.

Për Fabianin patriot pushtimi i Austrisë në vitin 1938 ishte një goditje e rëndë, e cila e bëri të vuante shumë dhe të shprehte zemrimin e thellë kundër diktatorit të Berlinit.

Padër Fabiani vdiq në Schwaz me 25 nëntor 1954, në moshën 86 vjeçare.

Vepra të Autorit

Romane e novela nga jeta shqiptare:

"Lule". Botuar në gjermanisht në Mynih në vitin 1924, shqip në Tiranë me 1930, kroatisht në Zagreb më 1939 etj.

"Kumbona e thyeme" (vepër e panjohur në Shqipëri).

"Gjaku i falun" (vepër e panjohur në Shqipëri).

Ditar nga jeta në Shqipëri:

"Ditari im Shqiptar", botuar në revistën *"Franzisziglocklein"*, në Austri (1926/1927).

Vepra arti:

"Shën Françesku drejton një vëlla plak drejt portës së qiellit", skulpturë e bërë nga P. Fabian Barcata më 1911.

"Statuja e priftit në meditim", vendosur në Schwaz.

Monumente, skulptura e piktura të tjera në Austri, Amerikë, Shqipëri.

EKSPOZITË

Objektet personale të Atë Gjergj Fishtës

Në 140 vjetorin e lindjes disa objekte të Gjergj
Fishtës ekspozohen në muzeun historik kombëtar në Tiranë

Në Tiranë, 25 tetor 2011 - Objekte personale të Gjergj Fishtës ekspozohen për herë të parë në 140 vjetorin e tij të lindjes. Bastuni (shkopi) i tij i vitit 1933, i gjetur në Hajmel te Mark Luka, tavolina e punës, makina e shkrimit, lahuta, janë disa nga objektet e veçanta, pjesë e ekspozitës së çelur pasditen e së hënës në Muzeun Historik Kombëtar. Marrë nga koleksione personale, në përkujtim të Fishtës janë ekspozuar edhe dorëshkrime, letër këmbime, fotografi, medalje, që dëshmojnë aktivitetin letrar të rilindësit, por edhe jetën e tij politike dhe përpjekjet për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë.

Ekspozita është konceptuar në dy pjesë. Në njërën pasqyrohet jeta e tij përmes fotografive, librave dhe objekteve personale, ku vihet në dukje edhe bashkëpunimi i Fishtës me shoqëritë patriotike e kulturore, pjesëmarrja në Kongresin e Manastirit, Konferencën e Paqes në Paris, etj.

Ndërsa në pjesën e dytë pasqyrohet veprimtaria e poetit në fushën e letrave mes ekspozimit të botimit origjinal të "Lahutës së Malësisë", apo "Mrizit të Zanave", veprimtaria si redaktor në revistat "Hylli i Dritës", "Zani i Shna Ndout", etj.

I pranishëm në çeljen e ekspozitës, ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Aldo Bumçi, tha se ruajtja e objekteve të Fishtës është një provë unike për popullin tonë pavarësisht dënimeve që ekzistonin në atë kohë. Për shkak të represionit sllavo-komunist ka qenë e vështirë gjetja sendeve personale dhe fotografive të Gjergj Fishtës. Në vitin 1945 filloi represioni sistematik ndaj klerikëve në Shqipëri e në veçanti ndaj veprës së tij.

Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Luan Malltezi, u shpreh se me veprat e tij, Fishta mbetet një emër i madh në kulturën shqipe të gjysmës së parë të shek XX.

Gjergj Fishta lindi në fshatin e vogël Fishtë të Zadrimës më 23 tetor. Teolog, shkrimtar (poet e prozator), historian, pedagog, filozof, piktor (mendohet të ketë mbi 20 piktura), deputet, është shqiptari i parë i kandiduar për Nobel për letërsinë.

Më 1913 botoi librin "Mrizi i Zanave" dhe pas 35 vjet pune, më 1937 nxori "Lahuta e Malcis", një vëllim prej 17 000 vargjesh, që u cilësua si lliada shqiptare ose Bibla e lëvruesve të shqipes.

Ishte kryetar i kongresit të Manastirit dhe propozimi i tij fitoi në unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Në tetor 1913 nxjerr revistën "Hylli i Dritës", ndërsa më 23 tetor 1913 shpalos flamurin kombëtar në kishën e Shkodrës, duke e lidhur atë me drita me xhaminë, për të treguar unitetin mes shqiptarëve. Gjergj Fishta mori shumë medalje të ndryshme nga populli i Shkodrës, i Beratit, mbreti i Austrisë, Greqia, Turqia, Vatikani...

VITRINË LIBRI

RAMAZAN VOZGA

Libri Shqip 1555-1912

Biblioteka Kombëtare
Tiranë 2010





PAPA GJON PALI II

Dhuratë dhe Mister

Arqipeshkvia Shkodër - Pult
Shkodër, 2011

PAPA GJON PALI II

Letra Apostolike

Arqipeshkvia Shkodër - Pult
Shkodër, 2011

KUMBONA E SË DIELLËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë